



# Mbrojtja

Viti i 88-të i botimit  
Tetor 2020/ Nr. 10



**Takimi i SHSHP të NATO-s**  
Gjeneralmajor Begaj në  
sesionin e 184 të Komitetit  
Ushtarak të NATO-s



**Komandanti i KFOR-it vizitë në vendin tonë**  
KFOR-i kontribues për  
sigurinë dhe ruajtjen e  
paqes në rajonin e Ballkanit



**Gjeneralmajor Begaj-kolonel Piccolo**  
Forcat e Armatosura  
të Italisë, një partner i  
rëndësishëm për FARSH



**MINISTRJA E MBROJTJES OLTA XHAÇKA**  
Krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës  
për rritjen e sigurisë në fushën e mbrojtjes

# Përmbajtja

Numri 10

## OPERACIONI I NATO-S "RSM"

- 7 Kohëzgjatja e misionit shqiptar është deri në 10 dhjetor 2021

## DEKLARATA

- 9 Ndërhyrje dhe parandalim ndaj dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

## KOMISIONI PËR SIGURINË KOMBËTARE

- 17 Prognoza 2020-2023, ecuria e punës dhe problematika e FARSH

## FORCA TOKËSORE

- 25 Pas stërvitjes 12 javore, përfundon Kursi XVI "Komando"

## AUTORË USHTARAKË

- 32 Zaim Kuçi dhe "Jeta e një piloti" në një libër

## STAFI

### DED KOLA

Shef i Sektorit të Botimeve & Kryeredaktor

### Gazetarë:

Mimoza GOLIKJA  
Saimir ALIJA

### Graphic Designer:

Afërdita HYSAJ



## 4 MINISTRJA E MBROJTJES XHAÇKA

Krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rritjen e sigurisë në fushën e mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, më 15 shtator 2020, kanë inspektuar punimet të rinovimit e strukturës...



## 15 TAKIMI

Forcat e Armatosura të Italisë, një partner i rëndësishëm për FARSH

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi më 29 shtator 2020, një takim me atasheun e ri ushtarak të Forcave të Armatosura të...



## 22 AKREDITIMI I AFA

Në tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA

Në tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA. Ky është edhe momenti kur akademia do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes...



## 26 BATALIONI III I KËMBËSORISË

Zhvillohet stërvitja 72 orëshe "Shqiponja Paqësore 20"

Batalioni III i Këmbësorisë (b3k) nga data 15 deri më 17 shtator, zhvilloi stërvitjen 72 orëshe "Shqiponja Paqësore 20". Kjo stërvitje kryhet për të testuar...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

# Mbrojtja



## REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror  
i Ministrisë së Mbrojtjes  
Viti i 88-të i botimit  
Nr. 10/ 2020

### © Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë  
revistë nuk mund të riprodhohen  
elektronikisht apo fizikisht e të  
përdoren për qëllime përfitimi, pa  
marrë autorizim nga botuesit e saj.

### Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,  
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut  
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe  
Botimeve të Mbrojtjes

### Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni “Skënderbej”

Revista mund të gjendet në formatin  
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/  
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





MINISTRJA E MBROJTJES OLTA XHAÇKA

## Krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rritjen e sigurisë në fushën e mbrojtjes

**Shtetet e Bashkuara po punojnë me partnerët shqiptarë për të minimizuar rreziqet dhe ndikimet e mbetjeve eksplozive të luftës**

**M**inistrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka dhe ambasadorja e SHBA në Tiranë, Yuri Kim, më 15 shtator 2020, kanë inspektuar punimet për rinovimin e strukturës speciale për eliminimin

e materialeve të rrezikshme në Batalionin e Xhenios në Komandën Mbështetëse, një bashkëpunim me Departamentin e Mbrojtjes të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Ambasadorja e SHBA ka vlerësuar kontributin që Shqipëria ka

dhënë përmes efektivëve të saj të Forcave të Armatosura në misione të ndryshme në kuadër të NATO.

Ambasada e SHBA në Tiranë zbardhi detaje nga takimi i ambasadores Yuri Kim dhe ministren e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, gjatë inspektimit më 15 shtator të punimeve në depot e



municionit.

Ambasada shkruan në 'Facebook' se Yuri Kim dhe ministrja Xhaçka kanë vizituar një prej projekteve të shumta për asgjësimin e municioneve në Shqipëri.

"Sot, Ambasadorja Kim dhe Ministrja e Mbrojtjes Xhaçka, vizituan një prej projekteve të shumta për asgjësimin e municioneve në Shqipëri, drejtuar nga Zyra e Bashkëpunimit Ushtarak. Nën programin e Ndihmës Humanitare të Minave, të Komandës Evropiane të Sh.B.A. (EUCOM), Shtetet e Bashkuara po punojnë me partnerët shqiptarë për të minimizuar rreziqet dhe ndikimet e mbetjeve eksplozive të luftës. Ky është vetëm një shembull se si partneriteti amerikan-shqiptar për

mbrojtjen po e bën Shqipërinë një vend më të sigurt për të jetuar", shkruan ambasada.

Nga ana e saj, ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka nënvizoi faktin se SHBA, si aleat strategjik ka treguar se vazhdon të qendrojë krah për krah Shqipërisë për modernizimin e FA për më shumë siguri dhe profesionalizëm në fushën e Mbrojtjes.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, shkruan ne facebook se: "Krah për krah me Shtetet e Bashkuara të Amerikës për rritjen e sigurisë në fushën e mbrojtjes. Me ambasadorën Yuri Kim sot inspektuam punimet për forcimin e kapaciteteve dhe rritjen

e masave të sigurisë, për depot e municionit në Batalionin Xhenio, në bashkëpunim me Departamentin Amerikan të Mbrojtjes.

Ky projekt, synon rritjen e kapacitetit të Forcave tona të Armatosura për të kufizuar rrezikun e ngjarjeve shpërthyes dhe të devijimit të paligjshëm, të municioneve dhe materialeve shpërthyes. Mbështetja e aleatëve për FA është pasqyra më e mirë e vlerësimit për Shqipërinë, si aleat i denjë dhe vend i sigurtë".

Në projekt parashikohet rinovimi për ruajtjen e sigurisë në Batalionin e Xhenios në Tiranë si edhe në depot e municionit në Mirakë, Elbasan.



# Ministrja Xhaçka takon drejtuesit e rinj të SHPFA

## Investimet për mbrojtjen në bashkëpunim me aleatët e partnerët

Xhaçka: “Kompensimi i ushqimit për 4000 efektivë të FA është një hap i parë i rëndësishëm drejt një trajtimi më dinjtoz e më vlerësues të kujtudo që shërben në FA”

Forcat e Armatosura të Shqipërisë kanë një staf të ri drejtues, pas emërimit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm gjeneralmajor Bajram Begaj. Në një takim me drejtuesit e rinj të Shtabit të Përgjithshëm të FA, zhvilluar më 19 shtator 2020, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka foli për vizionin e një FA moderne, të ndërtuar mbi meritokracinë e profesionalizmin për t'i dhënë standartet që i takon një vendi anëtar të NATO.

Sipas ministres Xhaçka, FA sot operon me dinjitet e standarde krahas për krahas ushtrive më të fuqishme në botë në misionet nga Afganistani e deri në Mali.

Reformimi i emergjencave civile, modernizimi përmes investimeve në fushën e mbrojtjes dhe bashkëpunimit me aleatët e partnerët, arsimimi dhe trajnimi financiar i FA janë renditur nga ministrja e Mbrojtjes si disa prej fushave ku janë shënuar hapa të rëndësishëm e me rezultate pozitive e me impakt të drejtpërdrejtë në atë që Forcat e Armatosura janë sot.



“Ia kemi dalë të rrisim trajtimin financiar dhe të rikthejmë kompensimin e ushqimit për 4000 efektivë të FA. Çka padyshim nuk mjafton, por është një hap i parë rëndësishëm drejt një trajtimi më dinjtoz e më vlerësues të kujtudo që shërben në FA”, - theksoi ministrja e Mbrojtjes. Ajo kërkoi nga stafi i ri bashkëpunim dhe përkushtim për të rritur profesionalizmin në rradhët e FA, që shumë shpejt do të hapë dyert për herë të parë për të gjithë ata të rinj që duan të ndjekin studimet për shkencë ushtarake.



# Xhaçka: Të shumtë ishin ata që nuk e besonin të mundur!

**P**aqja dhe bashkëjetesa janë e vetmja e ardhme që meritojnë qytetarët në Ballkan. Kështu ka deklaruar përmes një statusi në rrjetin social facebook, ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila ka përshëndetur arritjen e marrëveshjes mes Kosovës e Serbisë në Shtëpinë e Bardhë, në prani edhe të presidentit të SHBA Donald Trump. "Të shumtë ishin ata që nuk e besonin të mundur! Të shumtë ishin dhe ata që marrëveshjen nuk e donin e bënë gjithçka për ta bërë të pamundur! Por ja që kjo ditë erdhi! Erdhi jo si një mrekulli, por si rezultat i vizionit, besimit dhe guximit të atyre që kuptojnë, se paqja e bashkëjetesa janë e vetmja e ardhme që meri-



tojnë qytetarët e mbarë Ballkanit! Faleminderit miqve tanë amerikanë! Përgëzime kryeministrit Hoti e urime gjithë shqiptarëve të Kosovës! " -

shkruan ministrja Xhaçka. Ajo shton se "Sot u hodh një hap i madh dhe sot të gjithë duhet të bashkohemi për ta çuar punën e nisur deri në fund!"

## Operacioni i NATO-s "RSM", Afganistan"

**V**endimi i Qeverisë Nr. 695, datë 9.9.2020 "Për një ndryshim në vendimin nr.513, datë 13.7.2016, të Këshillit të Ministrave "Për pjesëmarrjen e një toge kembesorie të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në mision në Komandën e Trajnim-Këshillimit dhe ndihmës në Herat, në kuader të operacionit të NATO-s "RSM", Afganistan" është botuar në datë 14 shtator në Fletoren Zyrtare nr.164, pra ka hyrë në fuqi.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi: 1. Fjalja e parë, e pikës 4, të vendimit nr. 513, datë 13.7.2016, të

# Kohëzgjatja e misionit shqiptar është deri në 10 dhjetor 2021



Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon: "Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 10 dhjetor 2021.". 2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi,

të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. 3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

## Xhaçka: Janë rritur kapacitetet materiale ushtarake të FA

“Gjatë këtyre 3 vjetëve ia kemi dalë të modernizojmë FA për ta kthyer atë në një forcë profesioniste dhe pranë qytetarëve”. Kështu u shpreh ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, me 24 shtator 2020, në ceremoninë e 55-Vjetorit të Batalionit të Mbështetjes së Forcave të Armatosura, ku merrnin pjesë drejtues të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe ushtarake që ndër vite kanë drejtuar Batalionin e Mbështetjes.

Në këtë përvjetor që përkon dhe me 3-vjetorin e marrjes së detyrës si ministre e Mbrojtjes, Xhaçka theksoi se është ndërtuar një raport i ri me qytetarët duke iu gjendur atyre pranë në momentet e tyre më të vështira.

Ministria theksoi se krahas rritjes së kapaciteteve në pajisje dhe infrastrukturë, një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe investimit tek burimet njerëzore, si një nga asetet më të vjera.

Sipas saj, rillogaritja e vështirësisë së punës, rikthimi i kompensimit për ushqimin, certifikimi i Akademisë

Shqipëria jo thjesht një shtyllë stabiliteti në rajon, por një eksportues sigurie kudo ku Aleanca përballet me sfida



së Forcave të Armatosura si një institucion i arsimit të lartë, po i japin Forcave të Armatosura dinjitetin e duhur. “Në këto vite janë rritur më shumë kapacitetet materiale ushtarake të FA, që nga instalimi i Sistemit të Integruar të Vëzhgimit të Hapësirës Ajrore, pajisja me helikopterë Blackhawk apo certifikimi nga NATO i Batalionit Komando dhe

Grup-batalionit të dytë të Këmbësorisë, si dhe kompletimi me pajisje të standardizuara individuale të ushtarit për Forcën Tokësore”, - tha ministria e Mbrojtjes, teksa nënvizoi se aleatët e shohin Shqipërinë, jo thjesht si një shtyllë stabiliteti në rajon, por edhe si një eksportues sigurie kudo ku Aleanca përballet me sfida.

**110** rekrutë të rinj nga e gjithë Shqipëria, pas një procesi selektiv dhe testues në Qendrën e Personel-Rekrutimit filluan Programin e Stërvitjes Individuale Bazë, në Qendrën e Arsimimit Professional të Ushtarit (QAPU). Për arsye të masave të marra për mbrojtjen nga COVID-19, rekrutët do ta vijojnë trajnimin të ndarë në grupe përkatësisht në Qendrën e Arsimimit Professional të Ushtarit (QAPU), në Bunavijë, në Poshnje, Berat si dhe Vaun e Dejës, në Shkodër. Të rinjtë, të cilët janë pjesë e këtij programi po përgatiten nga një personel trajnues të cilët e kanë kthyer këtë proces të natyrshëm, duke sjell përherë suksesin e radhës falë punës dhe kontributit të tyre.

## 110 rekrutë të rinj filluan Programin e Stërvitjes Individuale Bazë





# Ndërhyrje dhe parandalim ndaj dëmeve nga fatkeqësitë natyrore

**26** shtator 2020: "Informacionet e marra nga Instituti i Gjeoshkencave, Ujit dhe Mjedisit dhe nga qendrat sinoptike homologe të vendeve fqinjë flasin për një fundjavë të karakterizuar nga stuhi dhe reshje të mëdha shiu, të cilat mund të jenë shkak për përmbytje në disa zona, kryesisht në prefekturat Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier apo Gjirokastrë", deklaroi ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka.

Në deklaratën për mediat ajo theksoi se "me qëllim marrjen e masave parandaluese dhe vënien në gatishmëri të strukturave operacionale në nivelin lokal dhe qendror, Ministria e Mbrojtjes, përmes Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, në bazë të ligjit "Për Mbrojtjen Civile" njoftoi në kohë prefekturat dhe pushtetin vendor, të cilët në bazë të ligjit janë reaguesit e parë në raste emergjencash.

Në këto dy vjet të kalimit të menaxhimit të emergjencave civile në përgjegjësi të drejtpërdrejtë, Ministria e Mbrojtjes krahas përbalimit të fatkeqësive ka pasur vëmendje të veçantë tek ndërhyrjet, për parandalimin e dëmeve që vijnë nga fatkeqësitë natyrore. Është edhe fal këtyre ndërhyrjeve të FA, mbështetur nga pushteti vendor, që sot, pavarësisht se reshjet kanë qenë dhe do të jenë intensive, situata, deri në momentin që flasim paraqitet e qetë, dhe vendbanimet që çdo vit kanë paraqitur situata të vështira përmbytjesh, nuk duket se mund t'i ekspozohen rrezikut të përvitshëm.

Që prej vitit 2018, Ministria e Mbrojtjes duke vlerësuar rreziqet e shkaktuar nga përmbytjet si një nga fatkeqësitë kryesore që prekin territorin e Republikës së Shqipërisë, ka ndërhyrë masivisht në forcimin e argjinaturave të lumenjve në disa nga zonat më të rrezikuara.

Në bashkëpunim me bashkinë Fier, efektivët e FA kanë përfunduar forcimin e argjinatura në lumenjtë Vjosa e Seman, duke kontribuar në sigurinë e banorëve të një zone që përmbytet çdo vjeshtë e pranverë. Falë projektit të përbashkët të Ministrisë



Strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qendror dhe vendor, bashkitë dhe prefekturat, Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit janë në gatishmëri për të reaguar në kohë dhe me efikasitet.



zjarresh e përmbytjesh.

Edhe pse gjatë këtyre ditëve, fatmirësisht për të gjitha arsyet që rendita më sipër, nuk kemi pasur të njëjtat situata me të cilat jemi përballur thuhet çdo vit, kryesisht në ato zona të cilësuar si zona të kuqe, moti i keq sërish mund të na ekspozojë në situata te papritura. Sistemet e kanalizimeve të dëmtuara, ndërtimet e pakontrolluara në zonat e rrezikuara, kolektorët e bllokuar e problemet e ndryshme që kanë ardhur nga zhvillimi kaotik i territorit i deri pak viteve më parë, sërish na ekspozojnë në probleme të mundshme sa herë prurjet paraqiten të jenë të një intensiteti të lartë.

Për këtë arsye, strukturat e Mbrojtjes Civile në nivel qendror dhe vendor, bashkitë dhe prefekturat, Forcat e Armatosura, Policia e Shtetit janë në gatishmëri dhe të mirë koordinuara për të reaguar në kohë dhe me efikasitet.

Jam shpresëplotë se, falë asaj çka kemi bërë, nuk do të përsëriten më situatat e viteve të shkuara, veçanërisht në Shkodër, Fier, Vlorë e Lezhë. Megjithatë, marr shkas t'i bëj apel çdo qytetari, që në rast rreziku nga përmbytjet të njoftojnë strukturat e tyre vendore të Emergjencave Civile, për të ndërhyrë në kohë apo të telefonojnë Nr. e Emergjencave 116 - 116. Bashkitë, prefekturat, specialistët e Mbrojtjes Civile në të gjithë vendin kanë koordinuar planet e masave dhe janë të angazhuar e të gatshëm, për çdo operacion ndërhyrjeje në ndihmë të kujt që mund të ketë nevojë e që rrezikohet nga shirat e vrullshëm, në mënyrë që mos cenohet asnjë jete njeriu, dhe të bëhet gjithë sa mundet për të parandaluar dëmet në bujqësi e blegtori".

# Takimi i Shefave të Shtabit të Përgjithshëm, të vendeve të NATO-s

## Gjeneralmajor Bajram Begaj në sesionin e 184 të Komitetit Ushtarak të NATO-s

Shefat e Shtabeve të vendeve të Aleancës u "mblodhën" virtualisht më 18 shtator 2022, në sesionin e 184 të Komitetit Ushtarak. Takimi u drejtua nga Air Chief Marshal Sir Stuart Peach, kryetar i Komitetit Ushtarak, mbështetur nga komandanti Suprem i Forcave Aleate në Evropë (SACEUR), gjeneral Tod Wolters dhe komandanti Suprem i Aleancës për Transformimin, (SACT), gjeneral André Lanata.

SHSHP të vendeve të NATO diskutuan për një sërë çështjesh që lidhen me angazhimet operacionale aktuale të NATO (Resolute Support Mission, misionin e NATO në Irak, misionin e KFOR), për Deterrence and Defence të hapësirës euroatlantike dhe çështjeve të tjera që lidhen me misionin e NATO. Ata diskutuan gjithashtu përparimin në zhvillimin e një koncepti kyç të NATO-s për armiqësitë, si dhe mësimet e nxjerra nga roli i organizatës në luftën kundër COVID-19.

Njëzëri të gjithë shefat rikonfirmuar qëndrimin e vendeve anëtare për vijueshmërinë e mbështetjes për misionet dhe operacionet në bazë të vendimmarrjeve politike, ndërsa mbi zbatimin e konceptit Deterrence and Defence të hapësirës euroatlantike, shefat e SHP vlerësuan punën e bërë nga komandat strategjike, transparencën mbi hartimin e këtyre dokumenteve dhe ofruan këshillim ushtarak mbështetur në pikëpamjet kombëtare.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj rikonfirmoi vijimin e kontributeve të



Shqipërisë në misionet, operacionet dhe aktivitetet e Aleancës. Në veçanti vlerësoi misionin e NATO-s në Kosovë si suksesin më të madh të NATO-s që prej krijimit të saj në fushën e operacioneve. Kjo ishte pjesëmarrja e parë e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, në këtë post të lartë ushtarak,

në takimin e Komitetit Ushtarak të NATO-s (KP), Komiteti Ushtarak i NATO-s në nivel shefash shtabi të përgjithshëm mblidhet dy herë në vit në Shtabin e NATO-s në Bruksel, dhe një takim, me rotacion, një herë në vit në një nga vendet anëtare të Aleancës. Takimi i radhës do të jetë në Greqi në shtator 2021



# Gjeneralmajor Begaj takon ambasadorin e Turqisë, Ahmet Yörük

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi me 11 shtator 2020, një takim me ambasadorin e Republikës së Turqisë në Tiranë Murat Ahmet Yörük. Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, atë rajonal por edhe më tej, në kuadër të misioneve dhe aktiviteteve të NATO.

Në kuadër të asistencës për situ-



atën e krijuar nga pandemia COVID-19, SHSHP falënderoi palën turke për mbështetjen materiale me pajisje mjekësore.

Bashkëpunimi ushtarak midis dy

vendeve shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, shëndetësore, modernizimin dhe logjistike dhe misioneve të NATO konkretisht kontingjenti i përbashkët ushtarak që shërben në Hamid Karzai International Airport, në Kabul, Afghanistan. Ambasadori i Republikës së Turqisë në Tiranë përcolli urimet nga titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Turqisë për marrjen e detyrës së SHSHP dhe vijueshmërinë e bashkëpunimit ushtarak midis vendeve.

## Takimi i 43-të i Ministerialit të Mbrojtjes të Europës Juglindore (SEDM-CC)

**N**ë datat 23-24 shtator 2020, në kuadër të Iniciativës të SEDM, i cili kryesohet nga Shqipëria, në Ministrinë e Mbrojtjes, u zhvillua nëpërmjet video-konferencës, Takimi i 43-të i Komitetit Koordinues të Ministerialit të Mbrojtjes së Europës Juglindore (SEDM-CC) dhe Takimi i 44-të i Komitetit Drejtues Politiko-Ushtarak/Forcës Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore (PMSC/MPFSEE).

Takimet u realizuan nëpërmjet video-konferencës me mbështetjen e portalit të SEDM si rezultat i situatës të pandemisë të COVID-19.

Përfaqësues nga 13 vende anëtare të SEDM, komandanti i Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG) si dhe vëzhgues nga NATO IS, UNDP SEESAC, RCC dhe RACVIAC, morën pjesë në këto takime, që u drejtuan nga zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi, njëkohësisht kryetar i Sekretariatit të SEDM-CC/PMSC.

Zëvendësministri i Mbrojtjes Petro Koçi theksoi në fjalën e tij se Iniciativa e SEDM ka treguar në gjithë këto vite se është një proces i shkëlqyer për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe dialogut të përbashkët në fushën e sfidave ndaj sigurisë. Detyra jonë është që

## SEDM-i është një proces bashkëpunimi rajonal në fushën e sfidave ndaj sigurisë

Në takim morën pjesë përfaqësues nga 13 vende anëtare të SEDM, komandanti i Brigadës së Europës Juglindore (SEEBRIG) si dhe vëzhgues nga NATO IS, UNDP SEESAC, RCC dhe RACVIAC



bashkërisht nëpërmjet këtij procesi të kontribuojmë në të mirë të paqes dhe stabilitetit rajonal. Në Takim e SEDM-CC u diskutuan projektet në kuadër të SEDM-it dhe pjesëmarrësit përshëndetën zhvillimin dhe përparimin e tyre, respektivisht ndërlidhjen e spitaleve ushtarake (Interconnection of Military Hospitals Project), promovimin e lidereve gra në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë (Female Leaders in Security and Defense -FLSD) në mbështetje të implementimit të rezolutës të UNSCR

1725, promovimin e institucioneve transparente në vënie të zbatimit të principeve të transparencës dhe integritetit (Building Integrity) si dhe zhvillimin e metejshmëm të Portalit të SEDM (SEDM Portal). Në Takimin e PMSC, u

diskutuan menaxhimi dhe dhënia e direktivave për të gjitha çështjet që lidhen me Forcën Paqeruajtëse Shumëkombëshe të Europës Juglindore si dhe zhvillimi i kapaciteteve dhe angazhimeve të ardhshme të Brigadës së SEEBRIG, për të cilën u aprovua Plani Vjetor për vitin 2021 dhe Buxheti i Brigadës për vitin 2021. Në klimën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit, vendet shprehën vullnet të përbashkët dhe vendosmëri për zhvillimin dhe forcimin e bashkëpunimit rajonal.

# Komandanti i KFOR-it vizitë zyrtare në vendin tonë

## KFOR-i kontribues për sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit

**N**ë kuadër të bashkëpunimit të FARSH me Komandën e KFOR, zhvilloi ditën enjte, më 3 shtator 2020, një vizitë zyrtare në vendin tonë, Komandanti i KFOR, gjeneralmajor Michelle Risi, i cili u prit nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Bajram Begaj.

Në takimin e zhvilluar midis shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj dhe komandantin e KFOR gjeneralmajor Risi, u vlerësua roli i KFOR-it në sigurinë dhe ruajtjen e paqes në rajonin e Ballkanit.

Gjatë fjalës së tij në takim, SHSHPFA, pasi shprehu mirënjohjen e burrave dhe grave nën uniform, të cilët shërbejnë në KFOR, ku edhe Shqipëria është pjesë, vlerësoi me nota pozitive rolin e gjeneralmajor Michelle Risi, në drejtimin e KFOR që prej nëntor 2019.

Nga ana e tij, gjeneralmajor Risi pasi e përgëzoi gjeneralmajor Begaj për marrjen e detyrës së lartë të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, vlerësoi performancën e personelit ushtarak që shërbejnë në KFOR, të cilët me rritjen profesionale dhe eksperiencën e përfutur do të jenë një vlerë e shtuar për FARSH në të ardhmen.

Të dy bashkëbiseduesit gjatë takimit ndanë të njëjtat qasje për situatën e sigurisë në rajon, rolin e NATO si dhe vijimin e bashkëpunimit mes FARSH dhe KFOR edhe në të ardhmen. "NATO është e bindur në mënyrë të vendosur për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor përmes forcës paqeruajtëse të KFOR-it me 3.500 trupa në Kosovë", deklaroi Jens Stoltenberg Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, në takimin në Bruksel me kryeministrin e Kosovës Avdulla Hoti më 7 shtator 2020. Ai nënvizoi se: "mandati i



**Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Bajram Begaj priti në takim Komandantin e KFOR, gjeneralmajor Michelle Risi. Motoja e Ris është "Stabilitet të Qëndrueshëm".**

KFOR-it mbetet i pandryshuar: të mbajë një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur dhe lirinë e lëvizjes për të gjithë njerëzit në Kosovë, në përputhje me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244 të vitit 1999".

\*\*\*

Gjeneral-major Michele Risi e mori detyrën si Komandanti i ri i KFOR-it, më 20 nëntor 2019. Detyrën e komandës e mori nga Ko-

mandanti Lorenzo D'Addario, në prani të Komandantit të Forcave të Përbashkëta Aleate në Napoli, Admiralit James G. Foggo III, presidentit të Kosovës Z. Hashim Thaçi, Ministrit të Mbrojtjes të Kosovës dhe Shefit të Mbrojtjes së Italisë. Gjatë fjalimit, Gjeneralmajor D'Addario theksoi: "Si organizatë ushtarake, ne kemi vazhduar që të sigurojmë se KFOR-i njihet si një Forcë e besueshme, e paanshme dhe e aftë të kontribuoi në mundësinë e hapësirës politike për zgjidhje të qëndrueshme". Nga ana tjetër, Admirali Foggo vlerësoi gjeneralin D'Addario: "Ka udhëhequr shkëlqyeshëm më shumë se 3.500 trupa që përfaqësojnë 28 kombe, duke ndërthurur aftësi taktike dhe qasje të mprehtë diplomatike". Kurse në deklaratën e tij të parë, Gjeneralmajori Risi prezantoi moton e tij "Stabilitet të Qëndrueshëm" dhe angazhimin për të mbështetur dialogun dhe bashkëpunimin: "Për të kontribuar në përparimin dhe stabilitetin në Ballkanin Perëndimor, një rajon me strategji të qëndrueshme, të rëndësishme për tërë regjionin e euroatlantikut".



**Komandanti i Komandës Tokësore Amerikane në Evropë**

# Gjenerallejtënant Cavoli: Shqipëria një partner besnik ndaj SHBA-së

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi më 17 shtator 2020, një video-konferencë me gjenerallejtënant Christopher G. Cavoli, komandant i Komandës Tokësore Amerikane në Evropë. Takimi vjen në kuadër të rritjes së bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve sidomos projekteve për modernizimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, por edhe stërvitjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, që kjo komandë do të zhvillojë në Shqipëri dhe rajonin e Ballkanit gjatë vitit 2021.

Gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve duke theksuar se “SHBA mbetet partneri më strategjik i Shqipërisë, i mbështetur në një histori të gjatë miqësie dhe partneriteti”. Bashkëpunimi ushtarak midis Shqipërisë dhe SHBA-shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, stërvitjes, modernizimit, logjistikës dhe misionëve me kontigjentë të përbashkët në Kosovë,



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj: “SHBA mbetet partneri më strategjik i Shqipërisë, i mbështetur në një histori të gjatë miqësie dhe partneriteti”.

Irak dhe Afganistan, ku forcat amerikane dhe shqiptare kanë luftuar krah për krah njëri tjetrit.

Gjenerallejtënant Cavoli vlerësoi rolin e Shqipërisë si partner besnik ndaj SHBA, si dhe shprehu gatishmërinë për mbështetjen për projektet në vazhdim dhe eksplorimin e fushave të reja të bashkëpunimit sidomos në atë të trajnimit të personelit për pajisjet e sistemet e dhuruara nga SHBA, por edhe stërvitjeve për rritjen e interoperabilitetit dhe testimin e gatishmërisë së forcave dhe pajisjeve.

Shqipëria do të jetë një nga vendet mikpritëse të stërvitjes “Defender-21”, e cila është stërvitja më e madhe e SHBA por edhe NATO për 2021, në kontinentin evropian.

Të dy bashkëbiseduesit diskutuan për situatën aktuale të sigurisë në rajonin e Ballkanit dhe rëndësinë e ruajtjes së paqes dhe stabilitetit në këtë rajon. Në këtë kuadër u vlerësua roli i SHBA si palë në disa nga forumet e sigurisë në rajon si Adriatik Charter (A - 5), mbështetja e saj për integrimin e disa nga vendeve në strukturat euroatlantike dhe bashkëpunimi i suksesshëm dypalësh për të promovuar vlerat e lirisë dhe paqes në rajon.

Gjenerallejtënat Cavoli uroi gjeneralmajor, prof. asoc. Begaj për marrjen e detyrës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe të dy shprehën edhe njëherë gatishmërinë për vijueshmërinë e bashkëpunimit ushtarak midis palëve.

# Bashkëpunimi me Kosovën dhe Greqinë në konsolidim të vazhdueshëm

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi ditën e enjte që kaloi, më datë 10 shtator 2020, takime me atasheun ushtarak të Republikës së Kosovës, kolonel Bashkim Shillova dhe atasheun ushtarak të Republikës së Greqisë, kolonel Efthymios Ntallas, të akredituar në vendin tonë.

Gjeneralmajor Begaj, gjatë takimeve vlerësoi bashkëpunimin ushtarakë bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal edhe më tej, në kuadër të misionëve dhe aktiviteteve të NATO. Në veçanti për bashkëpunimin me Forcën e Sigurisë së Kosovës, SHSHPFA gjatë takimit me atasheun ushtarak të Kosovës, kolonel Shillovën theksoi se: "Bashkëpunimi ushtarakë midis dy vendeve tona është në konsolidim të vazhdueshëm dhe i orientuar nga e ardhmja".

Më tej, u vlerësua bashkëpunimi në fushën e emergjencave, për të cilën gjeneralmajor Begaj përcolli falenderime edhe njëherë për kontributin e burrave dhe grave në



uniformë të Forcës së Sigurisë të Kosovës gjatë situatës të krijuar nga tërmeti i vitit të kaluar.

Ndërsa për bashkëpunimin ushtarak me Forcat e Armatosura të Republikës së Greqisë, një nga fushat që u vlerësua gjatë takimit të SHSHPFA me kolonel Ntallas ishte ajo e edukimit dhe trajnimit, ku shumë ushtarakë të Forcave të Armatosura shqiptare kanë ndjekur kurse të standardeve të NATO në institucionet ushtarake të Greqisë dhe anasjelltas, ushtarak të lartë të FA së Greqisë kanë qenë pjesë e vazhdueshme e Kursit të Lartë

për Sigurinë dhe Mbrojtjen, e organizuar nga FARSH. Gjithashtu, bashkëpunimi midis dy Forcave të Armatosura është i shtrirë në nivel NATO ku ushtarakët e dy vendeve shërbejnë sëbashku në operacionet dhe komandat e NATO.

Kolonel Shillova dhe kolonel Ntallas përcollën urimet nga titullarët e Forcës së Sigurisë së Kosovës dhe Forcave të Armatosura të Greqisë për marrjen e detyrës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH si dhe ndanë të njëjtin mendim për vijimin edhe në të ardhmen të bashkëpunimit ushtarak midis vendeve.

## Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH vizitë në Forcën Ajrore

# Forca Ajrore mban në gatishmëri kapacitetet ajrore të vendit

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vijoi turin e takimeve njohëse në Komandën e Forcës Ajrore. Në fjalën e tij në takimim e zhvilluar ditën e mërkurë, me 16 shtator 2020, me personelin e Forcës Ajrore SHSHPFA theksoi se "Forca Ajrore është një strukturë e rëndësishme jo vetëm për Forcat e Armatosura, por edhe për vendin. Kjo, jo thjesht për faktin se administron dhe mban në gatishmëri të gjitha kapacitetet ajrore të disa institucioneve të vendit, por për detyrat e veçanta, specifike, dhe në shumë raste, me vështirësi dhe

rrezikshmëri të lartë që kryen".

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj, solli në vëmendje përkujdesjen, motivimin dhe vlerësimin e veçantë që ka patur dhe vijon të ketë personeli i Forcës Ajrore, veçanërisht pilotët, duke njohur një përmirësim të konsiderueshëm bazuar në ndryshimet e fundit në trajtimin financiar të tyre. SHSHPFA u ndal edhe në investimet që janë bërë dhe vijojnë të bëhen në Komandën e Forcës Ajrore. "Nga ana

tjetër, edhe investimi për ngritjen dhe modernizimin e sistemit të vëzhgimit të hapësirës ajrore, të bazës së Kuçovës, pajisja edhe me disa helikopterë të tjerë nga aleatët tanë, sikurse ju e dini, tregojnë vëmendjen e shtuar ndaj Forcës Ajrore", theksoi gjeneralmajor prof. asoc. Begaj. Në mbyllje të takimit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH u njoh më nga afër edhe me ambientet e punës të Komandës së Forcës Ajrore.



**Gjeneralmajor Begaj priti atasheun italian kolonel Piccolo**

# Forcat e Armatosura të Italisë, një partner i rëndësishëm për FARSH

**S**hefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj zhvilloi më 29 shtator 2020, një takim me atasheun e ri ushtarak të Forcave të Armatosura të Republikës së Italisë, kolonel Nicola Piccolo. Ky takim vjen në kuadër të akreditimit të kolonel Piccolo si atashe ushtarak i Italisë rezident në Tiranë. SHSHP i FA-së e uroj bashkëfolësin për marrjen e detyrës dhe theksoi se: "Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve është i mbështetur jo vetëm në reciprocitet, por edhe një histori suksesi mbi 20 - vjeçare, prandaj ndjehem mëse i sigurt që do të vijojë të jetë i tillë edhe në të ardhmen."

Në takim mori pjesë edhe kolonel Fabio Cornacchia, i cili përfundoi mandatin si atashe ushtarak i Italisë në vendin tonë. Gjeneralmajor prof. asoc. Begaj



“Forcat e Armatosura të Italisë kanë qenë në krah të FARSH-it që prej vitit 1991, me projekte të shumta asistence për transformimin e saj në një forcë të standardeve të NATO-s”.

vlerësoi bashkëpunimin ushtarak bilateral midis vendeve në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes, atë rajonal por edhe më tej, në kuadër të misionëve dhe aktiviteteve të NATO-s. Forcat e Armatosura të Italisë janë një partner i rëndësishëm për FARSH, në këtë kuadër SHSHP vlerësoi dhe theksoi se: "Forcat e Armatosura të Italisë kanë qenë në krah të FARSH-it që prej vitit 1991, me projekte të shumta asistence për transformimin e saj në një forcë të standardeve të NATO-s".

Bashkëpunimi ushtarak midis dy vendeve shtrihet në fushat e edukimit, trajnimit, shëndetë-

sore, modernizimin dhe misionëve të NATO-s, ku ushtarakët shqiptar kanë qenë krah për krah me ushtarakët italian në një numër misionesh në Afganistan dhe Kosovë. Gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj vlerësoi kontributin e Italisë në KFOR, sidomos në drejtimin e këtij misioni të rëndësishëm dhe suksesshëm të NATO-s në rajon.

Atasheu ushtarak italian përcolli urimet nga titullarët e Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Italisë për marrjen e detyrës së SHSHP dhe të dy bashkëbiseduesit theksuan rëndësinë e vijueshmërisë së bashkëpunimit ushtarak midis vendeve.

# Forca Tokësore është forca më e angazhuar brenda dhe jashtë vendit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj zhvilloi me 15 shtator 2020, një takim njohës me strukturat e Komandës së Forcës Tokësore, ku u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai.

Pas pritjes me ceremoni nderi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, nëpërmjet një prezantimi të mbajtur nga komandanti i kësaj force, u njoh me misionin, detyrat dhe angazhimet e Forcës Tokësore brenda dhe jashtë vendit.

Gjatë prezantimit, ku ishin të pranishëm edhe shefat e degëve në Shtabin e Forcës Tokësore, Gjeneralmajor Begaj u njoh edhe me problematikën e hasura gjatë punës së përditshme të kësaj force.

Në fjalën e tij në këtë takim, SHSHPFA pasi i falënderoi për prezantimin e bërë, u shpreh:

“Unë jam sot këtu pikërisht për një njohje më nga afër me ju dhe me situatën e aktivitetin e forcës tuaj. Forca Tokësore është jo vetëm struktura më e madhe e Forcave të Armatosura, por njëkohësisht mbetet edhe forca më e angazhuar

Prioriteti kryesor do të jetë zhvillimi i kapacitetit të Grup Batalionit të Këmbëorisë së Lehtë (GBKL) sipas paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s



me detyra brenda dhe jashtë vendit. Sigurisht që unë jam në dijeni të këtij fakti, por prezantimi i paraqitur më shërbeu ta njohë gjendjen më në detaj”.

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj adresoi një falënderim të veçantë për përkushtimin dhe kontributin që kjo forcë ka dhënë në situata të vështira të vendit, sikurse ishte tërmeti i nëntorit, pandemia e COVID-19 dhe emergjencat civile. Ndër të tjera ai u shpreh:

“Mbi bazën e këtyre përvojave

dhe mësimave të nxjerra, unë e kam orientuar punën dhe aktivitetin e Forcave të Armatosura drejt një vizioni të ri, me të cilin ju jeni njohur. Megjithatë, unë e vlerësoj të nevojshme të theksoj drejtpërdrejt me komandat dhe personelin e Forcave të Armatosura prioritetet e punës time. Në këtë kuadër, prioriteti kryesor do të jetë zhvillimi i kapacitetit të Grup Batalionit të

Këmbëorisë së Lehtë (GBKL) sipas paketës së Objektivave të Kapaciteteve të NATO-s”.

Në përfundim të fjalës së tij në takimin me Komandën e Forcës Tokësore, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH u shpreh se Forca Tokësore do të jetë prioriteti kryesor i Shtabit të Përgjithshëm dhe do të ketë mbështetjen e plotë në realizimin e misionit, projekteve të modernizimit dhe objektivave të kapaciteteve.

Duke vazhduar takimet me strukturat e Forcave të Armatosura, ditën e mërkurë më 16 shtator 2020, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vijoi turin e takimeve në Batalionin e Policisë Ushtarake. Në takimin me Batalionin e Policisë Ushtarake, SHSHPFA adresoi një falënderim për të gjithë efektivet e kësaj strukture për përkushtimin në kryerjen e detyrave, në veçanti për angazhimet dhe kontributin e dhënë në situatat e vështira në shërbim të komunitetit, si në tërmetin e Nëntorit, dhe veçanërisht për menaxhimin e situatës agresive të fillimit të pandemisë së COVID-19. Ndër të tjera u shpreh se: “Policia Ushtarake është një strukturë e rëndësishme dhe e konsiderueshme e Forcave të Armatosura,

## Policia Ushtarake është një strukturë e rëndësishme e FA



në pikëpamje të detyrave dhe angazhimeve që ka, por edhe të misionit të saj specifik”. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj shprehu bindjen në përgjegjshmërinë dhe përkushtimin që do të tregojnë për kryerjen e detyrave dhe përballimin e vështirësive

dhe sfidave, ashtu si kundër i siguroi ata për mbështetjen e Shtabit të Përgjithshëm në realizimin e të gjitha objektivave. Në mbyllje të takimit, Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH u njoh më nga afër edhe me ambientet e punës të Batalionit e Policisë Ushtarake.



# Prognoza 2020-2023, ecuria e punës dhe problematika e FARSH

Komisioni për Sigurinë Kombëtare zhvilloi më 18 shtator 2020, një vizitë njohëse në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, me rastin e emërimit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj. Qëllimi i vizitës ishte njohja me vizionin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm në drejtim të Forcave të Armatosura, për periudhën 2020-2023, ecurinë e punës së deritanishme dhe problematikën e FARSH.

Kryetarja e Komisionit, Znj. Ermonela Valikaj (Felaj), pasi bëri fillimisht një prezantim të anëtarëve të Komisionit të Sigurisë Kombëtare, falënderoi SHSHP për punën e bërë nga efektivat e Forcave të Armatosura në përmbushje të misionit të tyre për ruajtjen dhe sigurinë kombëtare.



Më pas, takimi vijoi me një prezantim nga Drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Ilir Pujó, mbi misionin, detyrat, punën e deritanishme, pjesëmarrjen në misione dhe operacione ndërkombëtare, projektet e modernizimit dhe vizionin e SHSHP për FARSH.

Anëtarët e komisionit treguan interes të veçantë në disa çështje të caktuara, për të cilat adresuan dhe disa pyetje. Disa nga këto çështje kishin të bënin me: kursin e Pilotit në Forcën Ajrore, sistemin arsimor të

ushtarakëve, punën e personelit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), përfshirjen e grave në FARSH bazuar edhe në direktivat e Rezolutës 1325, projektet e modernizimit dhe pronat.

Në përfundim të prezantimit Znj. Felaj falenderoi Shefin e Shtabit të Përgjithshëm për pritjen dhe e siguroi atë se Komisioni është i gatshëm të mbështesë punën e FARSH për realizimin me sukses të objektivave të tyre sipas prioriteteve që Shtabi i Përgjithshëm ka vendosur.

SHSHP, gjeneralmajor prof. asoc. Bajram Begaj, falenderoi Kryetaren e Komisionit, znj. Ermonela Felaj dhe anëtarët për vizitën e tyre duke theksuar më tej se është shumë i rëndësishëm bashkëpunimi dhe mbështetja e Komisionit për Sigurinë Kombëtare në çuarjen më tej të punës së Forcave të Armatosura.

## SHSHPFA TAKIM NË KOMANDËN E FORCËS DETARE

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Bajram Begaj, vijoi turin e takimeve njohëse në Komandën e Forcës Detare. Në fjalën e tij në takimin me personelin e Forcës Detare SHSHPFA theksoi se "Forca Detare është një ndër strukturat kryesore të Forcave të Armatosura, e cila përveç misionit të saj kushtetues është duke kryer edhe detyra të tjera të rëndësishme, si ajo e rojës bregdetare. Angazhimi i suksesshëm me 14 kontigjente, i efektiveve të Forcës Detare në misionin e NATO-s "Sea guardian" në detin Egje tregon edhe më tepër rëndësinë që ka kjo forcë jo vetëm për vendin por edhe për Aleancën".

Më tej gjatë fjalës së tij, gjeneralmajor Begaj solli në vëmendje vizionin e ri me të cilin ai ka orientuar punën e Forcave të Armatosura, të cilat duhet të synojnë qasje të reja për rolin dhe kapacitetet e tyre.

## Forca Detare është një ndër strukturat kryesore të FA



"Për ta arritur këtë ne të gjithë kemi përgjegjësinë për të siguruar një mirëkuptim të plotë dhe efektiv në marrëdhëniet me njeri-tjetrin, ato civilo-ushtarake dhe padyshim besim e partneritetet me vendet e tjera." - u

shpreh ndër të tjera SHSHP.

Gjithashtu, gjeneralmajor Begaj adresoi një falënderim të veçantë për përkushtimin dhe kontributin që efektivi i kësaj force ka dhënë në situata të vështira të vendit, sikurse ishte tërmeti i nëntorit, pandemia e COVID-19 dhe emergjencat civile.

Në përfundim të fjalës së tij gjeneralmajor Begaj pasi shprehu bindjen në përgjegjshmërinë dhe përkushtimin që Forca Detare do tregojë në kryerjen e detyrave, dhe në përballimin e vështirësive dhe sfidave, i siguroi se: "Në këtë rrugëtim ju siguroj se do të keni të gjithë mbështetjen dhe angazhimin tim pa rezerva për realizimin e detyrave tuaja."

## Atashetë e huaj ushtarakë në mjediset e Komandës Mbështetëse

**D**elegacioni i atashëve ushtarakë të akredituar në vendin tonë, vizituan me 24 shtator 2020, mjediset e Komandës Mbështetëse. Qëllimi i kësaj vizite ishte njohja e tyre me kapacitetet dhe mundësitë që ofron Komanda Mbështetëse (KM), në përmbushje të misionit që ka Forca e Armatosur. Ata u pritën nga komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndriçim Sallaku, i cili nëpërmjet një përmbledhjeje të shkurtër, i njohu vizitorët me misionin, detyrat dhe rolin e Komandës Mbështetëse në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Gjatë prezantimit, përveç të tjerash të ftuarit u njohën me operacionet e ndryshme në kuadër të përballimit të situatave të EC, kontributet e kësaj komande në misionin eFP, Letoni, në kuadër të NATO-s, si dhe misionin EUTM Afrikë, në kuadër të BE dhe në mënyrë të veçantë me angazhimet e Komandës Mbështetëse gjatë pandemisë COVID-19,

Atashetë ushtarakë duke

Njohje me kapacitetet dhe mundësitë që ofron Komanda Mbështetëse (KM), në përmbushje të misionit që ka Forca e Armatosur



falënderuar për mikpritjen, vlerësuan në mënyrë të veçantë angazhimin e Komandës Mbështetëse dhe kontributin e saj në përballimin e situatave të EC, sidomos atyre të dy viteve të fundit, për tërmetet e vitit të kaluar dhe përballimin e situatës së krijuar së fundmi nga pandemia COVID-19.

Gjeneral brigade Sallaku, nga

ana e tij falënderoi të gjithë pjesëmarrësit për kontributin e shteteve respektive në mbështetje me trajnime, mjete dhe pajisje dhuruar Komandës Mbështetëse në funksion të realizimit të misionit të saj. Në përfundim të vizitës u shkëmbyen dhuratat nga të dy palët si dhe një foto e përbashkët.

**N**ë Komandën e Forcës Ajrore atashë ushtarak i Rumanisë kolonel Valerica Piroasca u prit nga zëvendëskomandanti i Forcës Ajrore kolonel Ylli Pulaj. Pasi i uroi mirëseardhjen në Komandën e Forcës Ajrore, kolonel Pulaj e njohu atashëun rumun me strukturën, kapacitetet dhe projektet kryesore të Forcës Ajrore.

Nga ana e tij, atashëun rumun bëri një ekspozitë të shkurtër të Forcës Ajrore rumune dhe u shpreh se deri tani nuk kemi patur bashkëpunim në fushën Ajrore por do të shikohet mundësia e bashkëpunimit dypalësh ushtarak në fushat Arsimimit dhe Trajnimit të personelit pilot dhe teknik në të ardhmen. Në përfundim të vizitës, kolonel Pulaj siguroi

## Do krijojmë bashkëpunim me forcat ajrore rumune

Atashëun ushtarak i Rumanisë kolonel Valerica Piroasca vizitë te Forcat Ajrore



atashëun ushtarak rumun se Komanda e Forcës Ajrore do të jëtë e gatshme të mirëpresë, t'i studiojë e,

pse jo, t'i realizojë ofertat e ardhura nga pala rumune, duke respektuar gjithmonë shkallën e hierarkisë.

**N**ë mjediset e Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua me 24 shtator 2020, ceremonia e përfundimit të Kursit 20-të të Lartë të Nënoficerit. Në këtë ceremoni mori pjesë Zv/Rektori i Akademisë së Forcave të Armatosura, kolonel Fatmir Neziraj, Komandanti i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve, kolonel Elton Bregu dhe personel tjetër drejtues i Qendrës së Arsimimit Profesional të Nënoficerëve.

Fjalën e hapjes në këtë aktivitet e mbajti Komandanti i Kursit të Lartë, Major Kujtim Zeka, i cili përpara kursantëve theksoi se: "Me nivelin e njohurive që keni arritur deri tani, shpreh bindjen time të plotë që në të ardhmen, ju do të jeni akoma edhe më të aftë profesionalisht, ku do të përmbushni me sukses detyrat që do tu jepen në vazhdim, duke qenë të denjë që të bashkëpunoni e të ballafaqoheni edhe me kolegët tuaj të vendeve anëtare të Aleancës".

Më tej fjalën e mori Rreshter Amrilda Sinanaj duke përshëndetur në emër të kursantëve. Ajo falënderoi trupën mësimdhënëse të ANO-së duke theksuar se "tashmë ne ndihemi më të sigurtë për të marrë

# Përfundon Kursi i 20-të i Lartë i Nënoficerit në ANO

Kursi i Lartë i Nënoficerit, u zhvillua në ANO për një periudhë 8-javore



përsipër me devotshmëri detyrat që do të na caktohen në të ardhmen, ku do të na kërkohet durim, sakrificë dhe profesionalizëm, si dhe u shpreh se tashmë ndihemi gati për të filluar arsimimin dhe kualifikimin në specialitetet përkatëse "

Fjalën për mbylljen e kësaj ceremonie e mbajti Zv/Rektori i AFA-së, Kolonel Fatmir Neziraj, i cili ndër të tjera tha: "Mbyllja me sukses e kursit të Lartë, në këtë periudhë të vështirë që po kalojmë për shkak të pandemisë Covid-19, si dhe periudhës së transformimit të rëndë-

sishëm në të cilën ndodhet Akademia e Forcave të Armatosura në këtë fazë ristrukturimi, shpreh qartë përkushtimin dhe këmbënguljen tuaj që keni shfaqur në realizimin dhe ezaurimin në nivel të lartë të programit mësimor të këtij kursi". Kursi i Lartë i Nënoficerit, u zhvillua në ANO për një periudhë 8-javore dhe pati si qëllim zhvillimin e elementeve themelore të personalitetit të Kapterit, si këshilltar i komandantit të nënrepartit dhe repartit dhe detyra të njehsuara me të. Ceremonia vijoi më shpërndarjen e çertifikateve.

## CINCU, RUMANI: 14 DERI MË 25 SHTATOR 2020

**N**ga data 14 deri më 25 shtator 2020 në rajonin stërvitor Joint National Training Center në Cincu, Rumani u zhvillua stërvitja "Carpathian Eagle 20".

Kjo stërvitje u realizua me pjesëmarrjen e 6 vendeve të Ballkanit: Shqipëri, Bullgari, Rumani, Greqi, Turqi, Maqedoni e Veriut. Stërvitje u zhvillua në nivel grupi special dhe shtab STOG, i cili ishte i përzier me personel nga të gjitha vendet pjesëmarrëse. Gjatë kësaj stërvitje u zhvilluan këto tema: qitje, LQB, air assault (fast rope, dylfer) shëndetsi, xhenio, etj. Kjo stërvitje ndërmjet Forcave Speciale kishte si qëllim forcimin e mëtejshëm të ndërveprueshmërisë në operacionet e spektrit të plotë për Forcat Speciale.

# Përfundon stërvitja "Carpathian Eagle 20"

Morën pjesë trupa nga 6 vende të Ballkanit: Shqipëri, Bullgari, Rumani, Greqi, Turqi, Maqedoni e Veriut



# Kolonelët Arben Kingji dhe Ilir Xhebexhia marrin gradën "Gjeneral Brigade"

Presidenti i Republikës dhe njëkosisht Komandant i Forcave të Armatosura z. Ilir Meta, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, znj. Olta Xhaçka, ka dekretuar kolonel Arben Kingjin me gradën madhore "Gjeneral Brigade". Me po të njëjtin propozim edhe kolonel Ilir Xhebexhia iu dha grada madhore "Gjeneral Brigade".

Kështu "në mbështetje të nenit 92, germa "d" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 3, germa "a", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, dekretohet Kolonel Arben Voke Kingji, me detyrë "Komandant", i Batalionit të Mbështetjes, në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, i jepet grada madhore "Gjeneral Brigade. Ky dekret hyn në fuqi menjëherë. Nr. i Dekretit 11703 Tiranë, më 11.09.2020".

Nga ana tjetër "në mbështetje të nenit 92, germa "d" dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 9, pika 3, germa "a", të ligjit nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes, dekreton, "Kolonel Ilir Hasan Xhebexhia, me detyrë "Zëvendës Përfaqësues Ushtarak në NATO, Atashe Ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë", në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendit, i jepet grada madhore "Gjeneral Brigade". Ky dekret hyn në fuqi menjëherë. Nr. i Dekretit 11704. Tiranë, më 11.09.2020".

\*\*\*

Kolonel Arben Kingji mban aktualisht detyrën e komandantit të Batalionit të Mbështetjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Gjeneral brigade Arben Kingji ka ushtruar edhe detyra të tjera si ajo e atasheut ushtarak të Republikës së Shqipërisë në Rumani. Me herët ai ka qenë edhe komandant i Policisë ushtarake. Ka kryer Kursin e Shtabit të Përgjithshëm në Akademinë e Mbrojtjes në Tiranë. Gjeneral brigade Kingji ka mbajtur detyrën e komandantit të kontigjentit në disa misione në Afganistan e Irak.



Kolonel Arben Kingji mban aktualisht detyrën e komandantit të Batalionit të Mbështetjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura



Kolonel Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendësperfaqësuesit ushtarak në NATO, atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendit.



Në vitin 2016 ai përfundoi edhe studimet për drejtësi në Winsdom University. Për kontributet e tij në Forcat e Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji është nderuar me disa medalje. Ai mban edhe medaljen e Artë të Shqiponjës, dhënë nga Presidenti i Republikës.

Kolonel Ilir Xhebexhia aktualisht mban detyrën e zëvendësperfaqësuesit ushtarak në NATO, atashe ushtarak i Republikës së Shqipërisë në Belgjikë dhe jo-rezident në Francë, në Përfaqësitë Ushtarake Jashtë Vendit. Ai ka përfunduar Kursin e Oficerit të Shtabit të Përgjith-

shëm në Akademinë e Mbrojtjes. Ndërsa në 2006-2007 ka qenë oficer koordinator, pranë Komandës Qendrore Amerikane Tampa-Florida USA. Ai ka ushtruar edhe detyra si zëvendëskomandant i Qendrës së Radio-Zbulimit, nënkolonel, oficer Shtabi për Inteligjencën, Përfaqësia Ushtarake - Bruksel.

Ai ka marrë pjesë në disa misione ndërkombëtare si: stërvitja "Rescuer", Maqedoni; oficer koordinator "Rescuer", Maqedoni; misioni i SFOR-it në Bosnje-Hercegovine; operacioni "Liria Irakut" (C-2 në CJTF-7) në Bagdad.

Në formimin e tij, tashmë gjeneral brigade Ilir Xhebexhia numëron edhe një sërë kursesh në Turqi, Gjermani, Greqi, Holandë. Gjatë karrierës së tij, gjeneral brigade Xhebexhia është vlerësuar me disa dekorata, përfshirë: "Medalja e NATO-s për Misionin e Paqeruajtjes" 1998, dhënë nga sekretari i Përgjithshëm i NATO. Ai botoi dy libra, "Liria e Irakut" në 2006 dhe "Evropa Juglindore Procesi Integruese" në 2007 dhe bashkëautor në disa botime të tjera.

Në mjediset e Batalionit Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm, u zhvillua ditën e martë më 22 shtator 2020, ceremonia e gradimit të gjeneral brigade Arben Kingji, të cilit iu akordua grada madhore me dekret të presidentit të Republikës, me propozim të ministres së Mbrojtjes.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhacka, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, komandantë forcash, drejtorë drejtorish në MM she SHP, si dhe ushtarakë të lartë e të ftuar të tjerë.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Olta Xhacka, pasi falënderoi të gjithë të pranishmit në këtë ceremoni, duke e konsideruar këtë ditë shumë të veçantë jo vetëm për faktin që sot do i vendosim gradat gjeneral brigade Kingji, por se kjo ditë përkon edhe me 55 - Vjetorin e Krijimit të Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Shtabin e Përgjithshëm.

Ministrja Xhacka vlerësoi përkushtimin dhe profesionalizmin gjeneral brigade Arben Kingji duke e cilësuar si një ndër ushtarakët më të spikatur të Forcave të Armatosura. "Gjeneral brigade Arben Kingji ka bërë një punë të shkëlqyer kudo ku ka shërbyer, si komandant në Batalionin "Komando", në Forcat Speciale, në Policinë Ushtarake, atashë ushtarak jashtë vendit e, së fundmi, komandant i Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm në FA.", u shpreh ministrja e Mbrojtjes znj. Olta Xhacka.

"Meritokracia-theksoi ministrja Xhacka - bazuar në profesionalizëm, pasionin e përkushtimin do të jetë guri i themelit për një Forcë të Armatosur profesioniste e të mirëorganizuar." Në fjalën e tij përshëndetëse, gjeneral brigade Arben Kingji duke e konsideruar këtë ditë shumë të veçantë si dhe nder dhe privilegj për të dhe familjen e tij, falënderoi ministren Xhacka për vlerësimin dhe besimin si dhe kolegët, duke u angazhuar se do ta mbajë me nder dhe përkushtim gradën e dhënë.

## Ministrja Xhacka gradon gjeneral brigade Arben Kingji

Meritokracia bazuar në profesionalizëm, pasionin e përkushtimin do jetë guri i themelit për një Forcë të Armatosur profesioniste e të mirëorganizuar.



### Ceremonia zhvillohet në Bruksel

## Gradohet gjeneral brigade Ilir Xhebexhia

Në Përfaqësinë Ushtarake të RSH në NATO, në Bruksel, është zhvilluar ceremonia e gradimit të gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, të cilit iu akordua grada madhore me dekret të presidentit të Republikës, nr. 11704, më 11.09.2020" me propozim të ministres së Mbrojtjes. Gradën gjeneral brigade ia dorëzoi Ambasadori i Republikës së Shqipërisë në NATO, zoti Visho Ajazi dhe përfaqësuesin Ushtarak të Republikës së Shqipërisë në NATO, Gjeneral Major Nazmi Cahani. "Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia i bashkohet grupit të oficerëve madhor të Forcave të Armatosura. Gjenerali i sapo graduar ka shërbyer si: zv.komandant në Qendrën e Radiozbulimit, shef sektori i operacioneve dhe stërvitjes në Forcën Tokësore, drejtor i drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA. Aktualisht atij i është besuar përgjegjësia e zëvendës Përfaqësuesit Ushtarak të RSH në NATO si dhe Atashë Ushtarak i RSH në Mbretërinë e Belgjikës, jo-rezident në Republikën e Francës", shkruan ministrja Xhacka në facebook. Në ceremoninë e zhvilluar në Bruksel, mori pjesë Përfaqësuesi Ushtarak i Shqipërisë në SHAPE, Kolonel Petrit Çuni dhe ushtarakë të tjerë.



# Në tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA

**N**ë tetor 2020 hapet programi bachelor në Akademinë e FA. Ky është edhe momenti kur akademia do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA, duke shërbyer në këtë mënyrë si një institucion i mirëfilltë publik i arsimit të lartë!

Akreditimi i Akademisë së FA si një institucion i arsimit të lartë, nuk është thjesht një mundësi për të përgatitur kuadro më të mirë për nevojat e mbrojtjes e sigurisë. Kjo është edhe një mundësi e jashtëzakonshme për të thithur talente të reja në familjen tonë, djem e vajza që do të shohin tek FA mundësinë reale për të ndërtuar një karrierë, si profesionistë të arsimuar. Një karrierë që më të aftët e të talentuarit prej tyre mund t'i çojë shumë larg e shumë lart, përtej radhëve të FA sonë, e deri në zyrat e Aleancës ku ne bëjmë pjesë.

Maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur shkencat ushtarake pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, si një prej degëve ku duan të studiojnë. Pak ditë pas përfundimit të aplikimeve, grupi i parë i të rinjve, nisi konkurimin me kontrollin mjekësor dhe testimin fizik përmes ekipit profesionist të mjekëve dhe pedagogëve e specialistëve të edukimit fizik në AFA. Në përfundim të konkurimit do zgjidhen 60 studentët e parë të AFA, që do të nisin vitin akademik në muajin tetor.

Më 28 gusht 2020 ka përfunduar Raundi i parë i aplikimit dhe regjistrimit pranë Akademisë së Forcave të Armatosura (AFA) në programin e studimeve në fushën e Shkencës Ushtarake. Raundi i dytë i aplikimeve nis nga data 19 deri më



Ky është momenti kur akademia do të rifitojë me të drejta të plota rolin e saj si një nga shtyllat e ringritjes dhe modernizimit të FA



21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura.

Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka bërë me dije përmes një postimi në rrjetet sociale se, në këtë periudhë, të gjithë maturantët që kanë mbaruar këtë vit arsimin e mesëm mund të aplikojnë në portalin

ualbania.al.

Gjithashtu aplikimi vijon të jetë i hapur edhe për maturantët e viteve të shkuara. Më 21 shtator përfundon afati edhe për këtë kategori aplikantësh, të cilët duhet të plotësojnë formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre.

AFA ofron një pagesë mujore për çdo student për të gjithë periudhën e studimit si dhe akomodim dhe ushqim falas për tre vitet e studimit. Çfarë është më e rëndësishmja, studentë nuk paguajnë asnjë tarifë për studimet dhe në përfundim të tyre punësohen përmes mundësive që japin FA. Në përfundim të Raundit të tretë pritet të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave të Armatosura.





## Akademia e Forcave të Armatosura

# Xhaçka: Raundi i dytë i aplikimeve, zgjidhje e sigurtë punësimi

Raundi i dytë i aplikimeve u zhvillua nga data 19 deri më 21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura.

**A**kademia e Forcave të Armatosura është në pritje të aplikimeve të maturantëve për raundin e dytë. Të gjithë të rinjtë që nuk patën mundësi të aplikojnë për të studiuar në Akademinë e Forcave të Armatosura (AFA) mund ta bëjnë këtë në fazën e dytë. Raundi i dytë i aplikimeve nis nga data 19 deri më 21 shtator për të gjithë ata që do të jenë brezi i së ardhmes në Forcat e Armatosura. Më 21 shtator përfundon afati edhe për këtë kategori aplikantësh, të cilët duhet të plotësojnë formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre.

Aktualisht po punohet për finalizimin e detyrave kryesore për aplikimin, testimin dhe regjistrimin e kandidatëve për studime në programin "Bachelor" në fushën e shkencës ushtarake.

Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka bën me dije se nëse një i ri është në dilemë për të zgjedhur studimet dhe punësimin, është pikërisht kjo akademi që u jep zgjidhje. "Dilemat më të mëdha të të rinjve sot janë studimet dhe punësimi. Zgjidhni Akademinë e Forcave të Armatosura dhe i keni zgjedhur të dyja. Nëse nuk e shfrytëzuar në fazën e parë, keni mundësi ta bëni tani. Akademia e Forcave të Armatosura ofron ndihmë të jashtëzakonshme gjatë studimeve dhe karrierë të sigurt pas përfundimit të tyre", -shprehet përmes një statusi në facebook, ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, më 3 shtator 2020.

Me qëllim vijimin e mëtejshëm të procedurave për rekrutimin e kandidatëve

për oficerë, Akademia e Forcave të Armatosura vë në dispozicion edhe njëherë për të gjithë maturantët, dokumentacinë e nevojshëm që nevojitet mbi kriteret dhe procedurat për rekrutim; formularin e të dhënave personale të aplikantit; formularin e vetëdeklarimit, si dhe të gjendjes shëndetësore të kandidatit për oficer aktiv. AFA ofron një pagesë mujore për çdo student për të gjithë periudhën e studimit si dhe akomodim dhe ushqim falas për tre vitet e studimit. Në fazën e parë aplikuan 675 maturantë për të ndjekur studimet bachelor, nga të cilët u përzgjedhën studentët e parë të shkollës ushtarake. Në përfundim të raundit të tretë pritet të kemi 60 studentët e parë të shkollës sonë ushtarake, shtyllës kryesore të formimit të Forcave të Armatosura.



## Trupat shqiptare në KFOR nderohen me medaljen e NATO-s

**T**rupat shqiptare në KFOR janë nderua të enjte, më 17 shtator 2020, me medaljen e NATO-s. Medalja e marrë nga trupat shqiptare vjen për shërbimin e realizuar në misionin e Aleancës për një vend më të sigurt. Lajmi për marrjen e medaljes e ka dhënë ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, e cila ka publikuar dhe foton e momentit të dorëzimit të medaljes nga përfaqësues të NATO-s tek trupat shqiptare. "Trupat shqiptarë në Kosovo Force-KFOR nderohen me medaljen e NATO-s, për shërbimin e tyre në misionin e Aleancës për një vend më të sigurt. Ne jemi NATO", theksoi Xhaçka.

## Ekspertët shqiptarë në Camp Adazi-Letoni

### Sigurohen 1400 efektive të NATO-s nga municionet e paplasura

**T**rupat e kontingjentit shqiptar në Letoni vijnë shërbimin në grup-batalionin e NATO-s në Camp Adazi, në përmbushje të detyrave ndaj Aleancës. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ndau me 11 shtator 2020 një video nga shërbimi i ekspertëve shqiptarë të bombave në Letoni, të cilët sipas saj, "mbajnë të sigurt 1400 efektive të grup-batalionit të NATO-s nga municionet e plasura dhe të paplasura". "Ekspertët tanë të bombave në Letoni vijnë shërbimin, për të mbajtur të sigurt 1400 efektive të grup-batalionit të NATO-s nga municionet e plasura dhe të paplasura në Camp Adazi. Ne jemi NATO", shkruan ministria Xhaçka.

**S**tudimet ushtarake janë një mundësi e mirë edhe për të gjithë të rinjtë që kanë përfunduar studimet bachelor në çfarëdo dege tjetër. Pas përfundimit të aplikimit, të rinjtë që shprehën dëshirën për të studiuar pranë Akademisë së Forcave të Armatosura kanë kryer edhe testin fizik, për të nisur tashmë kursin 1-vjeçar të oficerit.

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, teksa u bën thirrje të rinjve të ndjekin këto studime shprehet më 7 shtator 2020: "Forcat e Armatosura ofrojnë mundësi për karrierë për çdo të ri që dëshiron të shërbejë në uniformë. Krahas mundësive për maturantët që duan të ndjekin studimet në Shkenca Ushtarake dhe atyre që duan të shërbejnë si ushtarë, një mundësi e jashtëzakonshme u ofrohet edhe atyre që i kanë përfunduar tashmë studimet bachelor në çfarëdo degë. Këta të fundit u testuan fizikisht përpara se të nisin Kursin 1-vjeçar të Oficerit dhe të bëhen pjesë e FA". Këtë vit u ofruan 60 të drejta studimi për Oficer të ri,

## Gati për nisjen e kursit 1-vjeçar për oficer, përfundon testimi fizik



për të gjithë ata studentë që kanë përfunduar një fakultet tjetër.

Studimet në këtë kurs do të jenë sipas specialiteteve në FA, ku arsimiti universitar ju përafrohet, si: personel, logjistikë, xhenjo,

forca detare, sinoptika, këmbësoria, etj. Kandidatët e kursit një vjeçar të përgatitjes së oficerit të ri, ju nënshtrohen testimit të gjuhës së huaj, fizik, intelektual dhe atij psikologjik.

## Batalioni i Forcave Speciale dhe Batalioni i Mbështetjes me Luftim

**D**itën e martë, më 8 shtator 2020, në mjediset e Batalionit të Forcave Speciale (bFS) dhe Batalionit të Mbështetjes me Luftim (bML) u zhvillua ceremonia e prezantimit të komandantëve të batalioneve. Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, shefi i Shtabit të FT kolonel Ilirjan Dauti dhe shefat e degëve.

Gjeneral brigade Mullai gjatë prezantimit të komandantit të Batalionit të Forcave Speciale nënkolonel Ajet Jata dhe komandantit të Batalionit të Mbështetjes me Luftim kolonel Petrit Dajlani, vlerësoi punën dhe arritjet e shënuara nga këto dy reparte shumë të rëndësishme të Forcës

## Drejtuesit e rinj: Nënkolonel Ajet Jata dhe kolonel Petrit Dajlani



Tokësore. Ai i uroi suksese për detyrën komandantëve të rinj si dhe u kërkoi që aftësitë dhe për-

vojën e tyre t'a shpalosin më së miri në drejtimin dhe komandimin e reparteve që ata do të drejtojnë.



## Pas stërvitjes 12 javore, përfundon Kursi XVI “Komando”

*Trupat Komando kanë një histori të gjatë operationale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi*

**D**itën e hënë më 7 shtator 2020, në mjediset e batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVI “Komando”. Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel David Rroku, komandanti i batalionit Komando nënkolonel Edmond Doda, komandantë të reparteve të Forcës Tokësore si dhe familjarë të kursantëve.

Ky aktivitet, ndryshe nga herët e tjera, nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit në këtë ceremoni patën rastin të shihnin nga afër veprimet e trupave “Komando” në disa stacione si: kalimi i brezit të kalitjes, mbijetesa, përgatitje fizike me elementët e rinj sipas modelit amerikan, hyrje në godinë, çlirim pengjesh dhe qitje në nivel skuadre.

Më pas, fjalën e rastit në këtë ceremoninë e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, i cili iu shprehu kursantëve urimet më të mira: “... Sot tha ai, është dita që ju kurorëzoni përpjekjet tuaja 12 javore duke u stërvitur në kushte ekstreme moti dhe terreni, ditën dhe natën duke shpalosur karakterin dhe shpirtin luftarak e të pamposhtur ndaj çdo situatë në të cilën jeni përballur.



Trupat Komando kanë një histori të gjatë operationale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi. Ata kanë kontribuar jo vetëm në luftën kundër terrorizmit, por edhe në shërbim të paqes dhe sigurisë, krah për krah me Aleancën në Irak dhe Afganistan” - tha ndër të tjera gjeneral Mullai.

Komandanti i Forcës Tokësore, falënderoi për punën e shkëlqyer

drejtuesit e kursit kapiten Skrapalliu dhe kapiten Feti të cilët nën lidërshtipin e tyre dhe me punën e palodhur të instruktorëve realizuan me sukses Kursin XVI “Komando”.

Më pas, Zall-Herri gjëmoi sërish nga betimi i trupave “Komando”, një betim i cili bën krenar jo vetëm këto trupa, por të gjithë Forcën Tokësore. Ceremonia u mbyll me vendosjen e beretave dhe ndarjen e certifikatave.

**N**ga data 1 deri më 20 shtator, në rajonin e Macukullit bashkia Burrel u zhvillua stërvitja e koduar "Macukulli 2020". Kjo stërvitje, e cila u zhvillua nën drejtimin e Batalionit të Xhenios (bXh) dhe mbështetje e batalioneve të Furnizimit, Transportit dhe Mbështetjes Rajonale, si dhe pushtetit lokal të këtij rajoni, u realizua në zbatim të planit të aktiviteteve kryesore vjetore të Komandës Mbështetëse dhe FA, me qëllim rritjen e nivelit operacional të forcave xheniere, si dhe forcimin e mëtejshëm të nivelit të bashkëpunimit të Komandës Mbështetëse me pushtetin lokal, për ndërtimin e një segmenti rrugor prej 9 km. Pas planëzimit të detajuar të kësaj stërvitje, u krye lëvizja e forcave dhe mjeteve, ngritja e fushimit me elementët përkatës në rajonin e Macukullit.

Pas vendosjes së kontakteve dhe një organizimi të mirë me pushtetin lokal, u bë i mundur realizimi me sukses i detyrës për hapjen dhe rehabilitimin e segmentit rrugor "Shtjefën-Macukull". Gjatë punimeve për rehabilitimin e segmentit

# Përfundon stërvitja e koduar "Macukulli 2020"

Stërvitja ka kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës rrugore për fshatrat, Vig, Shëlli dhe Shtjefn dhe për 2000 banorët e kësaj zone



rrugor, punimet u inspektuan nga vetë komandanti i Komandës Mbështetëse gjeneral brigade Ndririm Sallaku, i cili falënderoi efektivat për punën e pa lodhur dhe në kushte të vështira infrastrukturore.

Kjo ishte një stërvitje e rëndësishme së veçantë për kontributin e rrallë që solli në përmirësimin e infrastrukturës rrugore për fshatrat, Vig, Shëlli dhe Shtjefn dhe 2000 banorët e kësaj zone.

**B**atalioni III i Këmbësorisë (b3k) nga data 15 deri më 17 shtator, zhvilloi stërvitjen 72 orëshe "Shqiponja Paqësore 20". Kjo stërvitje kryhet për të testuar dhe përmirësuar kapacitetet për kryerjen e detyrave në kuadër të operacioneve të mbështetjes së paqes si dhe ruajtjes së gatishmërisë.

Stërvitja u zhvillua në nivel kompanie, ku efektivet pjesëmarrës të Kompanisë III të b3k realizuan skenarë të ndryshëm, ditën dhe natën. Trupat testuan aftësitë për krijimin e pikave të kontrollit në mjedise jo të sigurta dhe terren të panjohur, shpërndarjen e turmave në situata të tensionuara, goditjen e objektit, brenda të cilit ka elementë të rrezikshëm, patrullimin si në këmbë dhe

# Zhvillohet stërvitja 72 orëshe "Shqiponja Paqësore 20"



me mjete, e deri te bashkëpunimi me pushtetin lokal në zonën e operacionit. Stërvitjet në kuadër të operacioneve të mbështetjes së

paqes do të vazhdojnë në b3k me stërvitjen "Shigjeta 20", e cila do të zhvillohet në muajin tetor me Kompaninë I.

Nën kujdesin Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, Bajram Begaj, efektivë të Forcave të Armatosura më datë 4 shtator 2020, kanë dhuruar vullnetarisht gjak në ambientet e Garnizonit “Skendërbej”, duke iu përgjigjur pozitivisht iniciativës “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”, për të kontribuar në ndihmë të fëmijëve talasemikë dhe njerëzve në nevojë. Iniciativa “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”, bëri bashkë personelin civil dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Forcës Tokësore, Komandës Mbështetëse, Arkivit të FA, Institutit të Gjeografisë Ushtarake dhe strukturave të tjera të FA.

Personeli civil i FA dhe djemtë e vajzat në uniformë të batalionit të Këmbëorisë Shkodër, Berat, b2k dhe atij Komando dhuruan gjak në praninë dhe kujdesin e personelit shëndetësor të Qendrës Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut, si dhe asistimin e personelit shëndetësor të Batalionit të Mbështetjes së Shtabit të Përgjithshëm duke respektuar rregullat e distancimit dhe në përputhje me udhëzimet e dhëna për situatën e krijuar nga COVID-19.

## Forcat e Armatosura i bashkohen nismës së dhurimit të gjakut

Iniciativa “Dhuro Gjak-Shpëto Jetë”, bëri bashkë personelin civil dhe ushtarak të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm, Forcës Tokësore, Komandës Mbështetëse, Arkivit të FA, Institutit të Gjeografisë Ushtarake dhe strukturave të tjera të FA



Fillimi i fushatës për dhurimin e gjakut është përshëndetur edhe nga Ministria e Mbrojtjes Olta Xhaçka, e cila teksa poston fotot e ushtarakëve, shkruan më 4 shtator 2020 se: “Kur bëhet fjalë për të shpëtuar jetë, Forcat e Armatosura janë të parët. Qendra e Transfuzionit nis fushatën për dhurimin e gjakut dhe Forcat e Armatosura janë të parët që i

përgjigjen apelit. Efektivë dhe civilë nga të gjitha forcat treguan sërish humanizmin e tyre për bashkatdhetarët tanë më në nevojë!” Gjatë ditës së premte, më 4 shtator 2020, numri i dhuruesve ishte relativisht i lartë, proces i cili po vijon në ditët në vazhdim edhe në strukturat e tjera të Forcave të Armatosura.

Dhurimi vullnetar i gjakut, tashmë është vlerë e shtuar e vajzave dhe djemve në uniformë dhe personelit civil duke e rritur kështu gamën e kontributeve të FA jo vetëm në misionet paqeruajtëse, luftarake, emergjenca të ndryshme në mbështetje të popullsisë civile siç ishin së fundmi tërmetet dhe pandemia por edhe në iniciativat e dhurimit të gjakut për të pasur gjak të mjaftueshëm e të sigurtë për të gjithë njerëzit në nevojë dhe kryesisht për fëmijët talasemikë.

## BATALIONI I XHENIOS (BXH) NË KOMANDËN MBËSHTETËSE

Struktura speciale për eliminimin e materialeve të rrezikshme EOD e Batalionit të Xhenios (bXh) në Komandën Mbështetëse sapo ka përfunduar me sukses dy operacione EOD përkatësisht në bashkinë Gjirokastrë dhe njësinë administrative Orikum të bashkisë Vlorë për identifikimin, heqjen dhe transportimin e municioneve, tip predha të kalibrave 76 mm dhe 122 mm.

Specialistët EOD pasi evidentuan prezencën e municioneve luftarake, konstatuan se municioni i gjetur në njësinë administrative Orikum ishte predhë e kalibrit 76 mm, e cila i përkiste Luftës së Dytë Botërore, ndërsa predha e kalibrit 122 mm u gjend në zonën industriale

## Eliminohen predhat e kalibrave 76 mm dhe 122 mm



Gjirokastrë dhe i përkiste periudhës së vitit 1997. Të dyja këto municione u hoqën dhe u transportuan

kundrejt rregullave dhe procedurave standarde duke eliminuar kështu rrezikun për popullsinë.

## Përfundon stërvitja detare "GRUPEX 20"

**M**ë datën 15 shtator 2020, në rajonin e gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja GRUPEX 20. Kjo stërvitje kishte qëllim certifikimin e Grupeve Patrullues të Flotiljes Detare. Në stërvitje morrën pjesë, përfaqesues nga shtabi i Forcës Detare, Shtabi i FDP-së, 6 anije të Grupit të I-rë dhe të II-të Patrullues, 1 skuadër e Grupit të Bordingut, gomonet e Anijeve të Klasit Iliria dhe elementë të Mbështetjes Shëndetësore. Stërvitja zgjati 2 ditë dhe u finalizua me qitje luftarake.

Në ditën e parë u përpunuan operacione të përballimit të rrezikut asimetrik, operacione të Kërkim-Shpëtimit SAR, vendosja e anijeve në formacion, operacione MIO (zbatim ligjshmërie), bordim anije, njeriu në det, rimorkim i anijeve, etj. Në ditën e dytë, herët në mëngjes, në rajonin e vetullores, Karabaran, u zhvilluan dhe qitjet bregdetare me artilerinë e Anijeve.

Qitjet u zhvilluan në distance të ndryshme, sipas kalibrave që posedonte cdo anije. Morrën pjesë anijët P-133, P-134, P-132, p-116, p-112 dhe P-02. Në kthim me anijet

Në stërvitje morrën pjesë, përfaqesues nga shtabi i Forcës Detare, 6 anije të Grupit të I-rë dhe të II-të Patrullues, 1 skuadër e Grupit të Bordingut, gomonet e Anijeve të Klasit "Iliria dhe elementë të Mbështetjes Shëndetësore



pjesmarrëse u zhvillua stërvitje ku u ripërpunuan elemente të stërvitjes së datës 15 shtator. Qitjet bregdetare dhe stërvitja me anijet u ndoqën nga afër nga Zv/komandanti i Forcës Detare, Kapiten i Rangut të

I-rë Ferdinand Kreshpani. Në fund, zoti Kreshpani përgëzoi personelin pjesmarrës në këtë stërvitje dhe qitje për përkushtimin e treguar në realizimin e detyrave dhe objektivave të caktuara.

## NË RAJONIN E VER-TOPIT, BERAT

**N**ga data 8-10 shtator 2020, kompania e III dhe IV e Aksioneve Speciale Direkte të Batalionit të Forcave Speciale zhvilloi stërvitjen "Tomorri-20" në rajonin e Ver-Topit, Berat. Kjo stërvitje u hartua në dy faza.

Faza e parë, stërvitje mbi procedurat e planëzimit sipas procesit të vendimmarrjes ushtarake sipas standardit të NATO (MDMP) për Forcat Speciale, si dhe faza e dytë, planëzim dhe zgjidhje detyre konkrete në nivel task-grupi të operacioneve speciale SOTG. Për realizimin e kësaj stërvitje u angazhua shtabi i dy kompanive në rolin e SOTG.

Gjatë planizimit u përdor koncepti i vlerësuesit të stërvitjes duke zbatuar listat e kontrollit për çdo fazë, hap, procedurën dhe veprimet konkrete operacionale. Listat

## Forcat Speciale zhvilluan stërvitjen "Tomorri-20"

Listat e kontrollit ishin hartuar sipas doktrinës së përbashkët të NATO për operacionet speciale AJP 3.5 si dhe atyre të dala nga manuali i NATO për SOTG



e kontrollit ishin hartuar sipas doktrinës së përbashkët të NATO për operacionet speciale AJP 3.5 si dhe atyre të dala nga manuali i NATO për SOTG. Pas përfundimit të stërvitjes u zhvillua analiza pas veprimit ku vlerësuesit, drejtuesit dhe pjesëmarrësit diskutuan se çfarë u bë mirë dhe çfarë nevojitet të përmirësohet sipas mësimave të nxjerra për tu integruar në programet e stërvitjes.

# Forca Tokësore e angazhuar në operacionet për shuarjen e zjarreve

**F**orca Tokësore është në gadhishmëri të plotë me qëllim përballimin e çdo situatë të krijuar nga rënia e zjarreve. 60 efektivë të Forcës Tokësore dhe Komandës Mbështetëse i janë bashkuar mëngjesin e ditës së dielë, më 13 shtator 2020, efektivëve të zjarrfikësve për shuarjen e zjarrit në fshatin Priskë, në Tiranë. Edhe pse në një terren të thepisur, ata kanë bërë të mundur shuarjen e zjarrit, duke shmangur rrezikun për banorët.

Më 15 shtator, repartet e Forcës Tokësore i janë përgjigjur menjëherë situatës së krijuar nga zjarret në zonat e njësive administrative Kolsh, fshati Manat, bashkia Lezhë. Me marrjen e sinjalit të emergjencës së rënies së zjarreve nga Qendra e Bashkuar Operacionale, repartet 1010 Vau i Dejës, Shkodër dhe reparti 1020 Tiranë kanë dërguar trupat e gatëshme në rajonin e Lezhës. Në këtë operacion u përfshinë 4 mjete dhe 40 trupa të pajisura me bazë materiale të dedikuara për shuarjen e zjarreve. Ky operacion vazhdoi pandërprerje ditën dhe natën, duke freskuar trupat e angazhuara në operacion.

Ndërkohë me 15 shtator një zjarr i madh ra gjatë natës në zonën e Kallmit, Durrës, ku për shuarjen e tij u angazhuan 3 automjete të



drejtorisë MZSH, 2 automjete të Portit dhe 1 automjet i Shijakut, me mbi 20 forca zjarrfikëse dhe 4 vullnetarë. Nga zjarri mësohet se janë djegur rreth 100 ha pisha dhe shkurre.

Në të njëjtën ditë është djegur sipërfaqe e tëra me ullinj e me pemë frutore në fshatin Kashar nr. 2, në vendin e quajtur "Pompata e ujit", ku zjarri kishte dalë jashtë kontrollit duke përfshirë sipërfaqe më të madhe. Menjëherë kanë shkruar në vendngjarje dhe falë veprimeve të shpejta kanë identifikuar dhe vënë në pranga autorin e zjarrvënies.

Policia e Tiranës njoftoi se ka arrestuar një 59-vjeçar në Kashar, pasi dyshohet se ka djegur sipërfaqe të

tëra me ullinj e me pemë frutore në Kashar. Sipas policisë, zjarri kishte përmasa të mëdha. Uniformat blu të kryeqytetit fton qytetarët të denoncojnë çdo rast paligjshmërie

Por në të njëjtën ditë zjarri, nuk ka dalë jashtë Tiranë dhe nga Kashari ka kaluar në Sauk, ku një zjarr i madh, shkaqet e rënies së të cilit nuk dihen ende raportohet se ka rënë në zonën e Saukut në kryeqytet. Qytetarët në panik dhe të shqetësuar pasi flakët po përhapen me shpejtësi, apelan për ndërhyrje.

Nërkohe me 16 shtator zjarr masiv përfshiu kurorën e gjelbër në Kodër Krastë në Elbasan ku mësohet se flakët kanë shkruar një sipërfaqe me pemë dhe shkurre. Në vendin e ngjarjes arriten shume shpejt forca ushtarake, zjarrfikëset dhe forca të shumta të policisë ku dyshohet se ky zjarr ka qenë i qëllimshëm. Kujtojmë se këtë verë, në vendin tonë, pemë, shkurre e pyje janë shkruar, për shkak të zjarreve nga temperaturat e larta ose zjarrvënies e qëllimshme. Në gatishmëri për shkak të kësaj situatë janë të gjitha repartet e Forcës Tokësore me qëllim përballimin e çdo situatë të krijuar nga rënia e zjarreve. Angazhimi i reparteve të Forcës Tokësore do të vazhdojë deri në përmirsimin e situatës së krijuar nga zjarret në Shqipëri.

## APLIKUAN PËR STUDIME NË SHKENCAT USHTARAKE

**P**as përfundimit të 280 aplikimeve të maturantëve në raundin e dytë, 26 të rinj, ku 8 prej tyre vajza, janë grupi i dytë që kanë zgjedhur të regjistrohen për të ndjekur studimet për shkencat ushtarake në Akademinë e Forcave të Armatosura", thuhet në njoftimin për media në faqen e web të Ministrisë së Mbrojtjes, të datës 27 shtator 2020.

Sipas njoftimit zyrtar, "maturantët e regjistruar iu nënshtruan kontrollit mjekësor dhe testimit fizik përmes ekipit profesionist të mjekëve dhe pedagogëve e specialistëve të edukimit fizik në Akademinë e Forcave të Armatosura. Testimi

## Raundi i dytë, në 280 aplikime, ka 26 fitues ku 8 janë vajza

Aplikantët iu nënshtruan kontrollit mjekësor dhe testimit fizik përmes ekipit profesionist të mjekëve dhe pedagogëve e specialistëve të edukimit fizik në AFA

fizik ka karakter skualifikues.

Testi fizik në tre disiplina, vrap, pompa dhe muskuj barku, duke qenë hapi i parë i konkurrimit pati si qëllim verifikimin e standardeve fizike që kandidatët duhet të plotësojnë për t'u futur në radhët e Forcave të Armatosura. Kandidatët u lejuan të marrin pjesë në testimin fizik pas

konkludimit nga ekipi i mjekëve për aftësinë shëndetësore të tyre, sipas raportit mjekësor të lëshuar nga komisioni përkatës. Kandidatët para përmbylljes së procesit të konkurrimit kaluan dhe fazën e intervistës. Me përfundimin e raundit të dytë numri i fituesve shkon në 38 nga 955 aplikime".

**M**e propozimin të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli Ministrave ka miratuar vendimin për "Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, të një sipërfaqeje truadhi funksional dhe të disa objekteve, brenda territorit të pronës Nr.98, me emërtim "Grup depo (Ish reparti ushtarak Nr.5001)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin Nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listes së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, të ndryshuar".

Vendimi i mësipërm është marrë në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c", të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar.

Këshilli Ministrave më datë 27 gusht 2020 ka miratuar ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Kulturës, të një sipërfaqeje truadhi funksional dhe të disa objekteve, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 488 (dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, nga truadhi funksional i pronës nr.98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reperti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për magazinimin e dekoreve dhe skenografisë së institucionit në varësi të saj, për Teatrin e Operas, Baletit dhe

## Ministria e Mbrojtjes: Sipërfaqja 2.488m<sup>2</sup> në Brar i kalon Ministrisë së Kulturës



Ansambli Popullor.

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar, të hiqen truadhi funksional dhe objektet, sipas planrilevimit, me sipërfaqe të përgjithshme prej 2 488 (dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, nga truadhi funksional i pronës nr.98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reperti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ,ose në përdorim Ministrisë së Kulturës.

Ministrisë së Kulturës i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të objekteve dhe sipërfaqes së pronës nr.98, të përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetër-

sojë ose t'ua japë atë në përdorim të tretëve.

Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës, para fillimit të punimeve, Ministria e Kulturës të ndërtojë rrethimin në kufijtë e rinj të pronës dhe çdo element që lidhet me rrethimin, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e sipërfaqes së pronës e cila i kalon në përgjegjësi administrimi, sipas parametrave dhe kushteve teknike dhe për këtë të hartohet aktmar-rëveshje ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Ministrisë së Mbrojtjes, të përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Komanda Mbështetëse.

Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me vendimin nr.515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, përmasat e pronës nr.98, me emërtim "Grup Depo (Ish-Reperti Ushtarak nr.5011)", me vendndodhje në Brar, Tiranë, zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin standard të inventarizimit dhe në planrilevimin që i bashkëlidhen këtij vendimi. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Kulturës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare"

**N**ë datë 23 shtator në Camp Villagio Italia, Pejë, Kosovë u zhvillua ceremonia e përfundimit të garës "Medalja e Aftësisë së Forcave të Armatosura të Gjermanisë". Në këtë garë morën pjesë efektivet e Kontigjentit të 7-të të Batalionit Komando, të cilët u renditën të parët duke fituar medalje ari të dhënë nga gjeneral brigade Frank Thomas Best, drejtori i NATO Advisor Liaison Team. Disiplinat në të cilat u testuan ishin: marshim

## Komandot fitojnë Medaljen e Aftësisë së Forcave të Armatosura të Gjermanisë

12 kilometra me ngarkesë, vrapim shpejtësie 1000 metra, vrapim me pengesa 100 metra, dhënia e ndihmës së parë, qitje, qëndrim në hekur tek, veshja e kundragazit dhe

not në distancë 200 metra. Fituesit e garës janë: nëntoger Astrit Çikaj, ushtar IV Ardit Xharri, ushtar IV Fatjon Pançi, ushtar IV Naim Ibrahimaj dhe Ushtar III Naim Kastrati.

# Kalim i përkohshëm pronësie pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare

Në mbledhjen e Qeverisë të datës 16 shtator 2020, u miratua vendimi "Disa shtesa dhe ndryshime në vendimin Nr.328, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhes, në Objektin Nr.1, tre kat, pjesë e pronës Nr.1047, me emërtim "Reparti Ushtarak Nr.6620 (PU)", me vendndodhje në lagjen "30 vjetori, Berat, dhe shfuqizimin e vendimit Nr.114, datë 17.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, nga Ministria e Mbrojtjes të Drejtorisë dhe Përgjithshme e Arkivave për degën e Arkivit Shtetëror vendor, Berat, të katit të parë e të katit të dytë të objektit Nr.1, dhe objektit Nr.2, pjesë të pronës Nr.1047, me emërtim "Qender Mobilizimi", me vendndodhje në Berat".

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 12, të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave vendosi që në vendimin nr.328, datë 22.4.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

Pika 1 ndryshohet, si më poshtë



vijon: "1. Dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, për një periudhë 20-vjeçare, nga Ministria e Mbrojtjes të Shërbimi Informativ i Shtetit, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, në objektin nr.1, tre kat, pjesë të pronës nr.1047, me emërtim "Reparti ushtarak nr.6620 (PU)", me vendndodhje në lagjen "30-Vjetori", Berat, sipas planrilevimit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m<sup>2</sup>, pjesë e pronës nr.1047, sipas planrilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse të tij, për ta përdorur për vendosjen dhe zhvillimin e aktivitetit të administratës së Drejtorisë Vendore të Shërbimit Informativ të Shtetit, në Berat."

Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon: "3.Ministria e Mbrojtjes, e përfaqësuar nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Policia Ushtarake dhe Shërbimi Informativ i Shtetit të lidhin aktmarrëveshje ndërmjet palëve për dhënien në përdorim të përkohshëm, pa shpërblim, të katit përdhes, me sipërfaqe 198 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup>, në objektin nr.1, tre kat, pjesë të pronës nr.1047, me emërtim "Reparti ushtarak nr.6620 (PU)", sipas planimetrisë, si dhe të sipërfaqes truall (oborr) prej 312 (treqind e dymbëdhjetë) m<sup>2</sup>, pjesë e pronës nr.1047, sipas planrilevimit, me vendndodhje në lagjen "30-Vjetori", Berat, duke përcaktuar kushtet dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet palëve.". Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

## POLIGONI KOMBËTAR NË BIZË

Në kuadër të stërvitjeve të planëzuara për vitin 2020, në datat 23 dhe 24 shtator në Poligonin Kombëtar të Bizës u zhvillua qitje luftarake me armët kolektive. Në këtë aktivitet stërvitor morën pjesë efektivë nga të gjithë repartet e Forcës Tokësore. Këto qitje u zhvilluan në distanca të ndryshme sipas kalibrave të armëve. Qitjet u ndoqën nga afër nga komandanti i Forcës

# Zhvillohet qitje luftarake me armët kolektive

Tokësore, gjeneral brigade Albert Mullai, shefi i Shtabit të FT kolonel Ilirjan Dauti dhe shefat e degëve. Në fund, gjeneral brigade Mullai, përgjë-

zoi personelin pjesëmarrës në këto qitje për përkushtimin e treguar në realizimin e detyrave dhe objektivave të caktuara.

## Zaim Kuçi dhe “Jeta e një piloti” në një libër

Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

### Një copëzë e jetës fluturuse të një ushtaraku

Libri “Jeta e një piloti” të autorit ushtarak Zaim Kuçi është një libër sa profesional aq dhe i frymëzuar për dashamirësit e aviacionit. Leximi i librit është i këndshëm dhe me shije artistike, ku autori falë kulturës dhe njohurive të gjera në fushën e aviacionit luftarak dhe civil, të mbërthen dhe të fut gjithmonë në ndodhi dhe ngjarje realie dhe të gërshetuara bukur me kohën. Gjatë leximit të librit futesh në botën e fluturimit, pasi aturi shumë natyrshëm të ka marrë me vete në kabinën e avionit luftarak, dhe këtë e ka bërë si një profesionisti aktiv i botës së qiejve. Në çdo faqe të librit ndesh me dashurinë e autorit për profesionin e tij, i cili e lidhi fatin e jetës me fatin dhe të ardhmen e armës së fuqishme të Aviacionit...

Mjaft bukur në libër autori Zaim Kuçi ka arritur të realizojë një ballafaqim tëpërvojës së tij ushtarake me historinë e aviacionit shqiptar. Në të gjitha etapat e jetës së tij ushtarake ai ka ditur të vërë në dukje politikat e mbrojtjes, ka realizuar me mjeshtëri historinë e vet, duke qenë vet protagonist i saj dhe i armës së aviacionit shqiptar. Jetën e tij e nis që nga momenti që shkeli në auditoret ushtarake, shkollat, fluturimit me avion luftarak të llojeve të ndryshme, tregon ngjarje tepër thjeshtë por që jehojnë gjatë në memorie, tregon për arritje të fushës ushtarake, por dhe në diplomaci, ku u vlerësua nga Presidenti i Francës Nikola Sarkozy me medaljen “Kryqi i Urdhërit Kombëtar të Meritës”. Nga njëri syth i librit në tjetrin ndeshim në formim akademik, në profesionalizmin, në intelektu-



Aviatori Zaim Kuçi është vlerësuar nga Presidenti i Francës Nikola Sarkozy me medaljen “Kryqi i Urdhërit Kombëtar të Meritës”

alizmin, në diplomatin e kohës duke na përshkruar plotësisht karakterin atdhetar, kolonelin pilot, dhe njeriun e mirë që natyrshëm dhe bindës, tregon të mirë dhe se çfarë duhej të ishte bërë më mirë. Në trazicionin e gjatë të Forcave të Armatosura dhe shqiptar, autori ka dhënë pilotin e pjekur, guximi për të provuar, avionin luftarak dhe rregullin ushtarak duke marrë suksesin, por dhe propozon për model zhvillimi të armës së aviacionit.

Libri vërtet është një copëzë e jetës fluturuse të një ushtaraku, ku gjen njohuri për mjetin fluturues, tregon si ishin avionët mig që pilotuan pilotët heronj të aviacionit, tregon shkëlqimi dhe venitjen e tyre. Ky libër është i një lloi të veçantë, del fenomeni, ngjarja, bukuria, informimi dhe mësimi, në çdo faqe ka emocion. Libri me modestinë e tij, autori ushtarak gjen veten dhe civil, të ul në kabinën e avionit dhe nis fluturimin në rrugën e jetës së pilotit Zaim Kuçi.

### Fëmijëria dhe dëshira për pilot

Autori tregon se erdhi në jetë nga një familje modeste, as nga librat dhe as nga pasuria por nga ndershmëria. Librat i kërkoi për të gjetur pasurinë shpirtërore dhe jeta ja dhuroi ato... Fare pranë fshatit Drobonik të Beratit gjendej baza ajrore e Kuçovës. Fluturimi i avionëve mbi kokat e fëmijëve ishte kureshtje për ta. Fluturimi i avionit mbi fshat thekson autori, ishte për mua një kënaqësi dhe e desha zhurmën e tij. Në Berat pashë një burrë të veshur me uniformën e fluturimit. Babai i tha, ky është piloti që na zhurmon mbi kokat tona. Piloti i përshëndeti dhe Zaimit

i ngelën sytë tek kostumi i bukur i fluturimit. Duke filluar nga viti 1967, prej fshatit Drobonik kreu arsimin tetëvjeçar në shkollën “24 Maj” në Beratit duke bërë në ditë mbi dy orë rrugë. Me vështirësive shpesh e fillonte ditën duke tharë rrobat e trupit pranë sobës te salla e mësuesve. I kishte vënë vetes detyrë që të bëhej pilot...

### Shkollat ushtarake që formonin dinjitetin e ushtarakëve

Në shtator 1971 nisi studimet në shkollën ushtarake “Skënderbej”, cila vlerësohej si një privilegj, e krahësuar me vështirësitë e shkollës tetëvjeçare. U nis kështu një jetë ndryshe, në një shkollë me disiplinë të rreptë. Me programin mësimor të larmishëm, me një trupën pedagogjike të përzgjedhur, të përkushtuar, si ushtarakët dhe mësuesit civilë, formuan dinjitetin e oficerëve të ardhshëm. Kjo shkollë ishte përgatitje e madhe për të përballuar vështirësitë e ushtarisë. Ndërsa në shkollën e Lartë të Aviacionit, nisi dhe rrugëtimi i vështirë, por me pasion dhe me guxim për fluturimin. Fluturimi shkruan autori është diçka ndryshe, është pak i njohur, ka emocion, është art mbi artin. Këtu mësoi se po e shijove fluturimin, ecën gjithnjë me sytë nga qielli. Libri flet, ngacmon dhe tregon në heshtje, jetë dhe histori fluturimesh. Të gjithë pilotët i ruajnë kujtimet e tyre në librezën e fluturimit, në kostumin e lartësisë dhe mbingarkesës... në maketet e avionit, në librezën shëndetësore, në





lapsin e lidhur me spango, në bllokun e shënimeve që ishin të pranishme në kabinën e avionit çdo ditë fluturimi. Të gjitha këto kanë vlera, sepse kanë djersë e lot nga qielli, janë gjurmë për të gjithë ata që kanë fluturuar.

### Fluturimi i parë...

Pas një rrugëtimi dyvjeçar, formimi teorik, pune dhe ëndrrash përballë mjetit fluturues, vjen momenti final, hapi i guximshëm drejt qiellit. Mjaf-tuan 8-10 min fluturim dhe merr fund gjithçka, të shtjelluar mirë apo keq në qenien e studentit për pilot, një kohë e shkurtër e qëndrimi i vetmuar në ajër. Pasi ke bërë 60-70 fluturime me instruktorin dhe pilotët vlerësues erdhi dhe momenti i shumëpritur për të fluturuar vetëm. Autori thekson se në kufje ende dëgjon zërin e tij në ngritjen e parë në ajër: -566 më lejoni ngritjen vetëm. Nga ana tjetër dëgjohej ju lejoi ngritjen vetëm 566. Veshët i gumë-zhitën 56666. Kthen kokën mbrapa për të parë instruktorin dhe kupton se ishte vetëm në kabinë. Emocione dhe për uljen në pistë. Drejtoi avionin në vendin e pritjes, instruktor Perlati, doktori dhe shokët vrapuan drejt avionit, erdhën nga kulla e drejtimit dhe pilotët drejtues të aviacionit. Student pilot Zaim Kuçi ishte i skuqur dhe në djersë... Ndjeu mall për prindrit dhe ju duk se i kishte pranë dhe ata po ëm-bëlsoheshin me çokolatat e urimit të daljes vetëm në qiellin e Atdheut.

### Fluturimi në avionin reaktiv Mig-15

Pas hedhjen me parashutë dhe pas një seleksionimi të rreptë në avionin Tip-61, në vitin e tretë akademik vijonte dhe përfundonte programi në avionin reaktiv. Shkolla përgatiste pilotët për të fluturuar në Mig-19/21. Selektimi ishte i rreptë, parashikues, pa alternativë vijuese. Diplomohej më i miri për të shkuar në regjimentet luftarake. provën e kaloi në saj të instruktorit Kujtim Osmani dhe komandantit të

katërshes, pilotit të talentuar Isa Arapi. Gjatë stazhit njëvjeçar në avionin Mig-17, cilësia e fluturimeve u rrit dhe nuk i munguan vlerësimet nga komanda e skuadriljes, Pandeli Lëngu, Harilla Rebi, Viktor Vangjeli dhe Agim Balili. Me instruktor Gjergji Spaho ishim bërë shokë dhe shpesh thyenim disiplinën duke fluturuar në lartësi të vogla në Berat dhe në fshatin Drobonik ku kishte prindërit e tij. Gjatë studimeve në Akademinë e Aviacionit, përvehtësohen tipat e avionëve Jak 18, Mig-15 dhe Mig-17 dhe në fund të programit mori librezën e fluturimit me 490 fluturime, pjesë e programit të shkollës, e cila konsiderohej "sekret", sepse shënohej sasia, koha, lloji i fluturimit dhe rezultati i vlerësuar me notë. Autori tregon histori konkrete nga jeta në Akademinë e Forcave Ajrore kur fluturoi me avionin reaktiv Mig-17 në Kuçovë. Akademia i diplomonte studentët me titullin "Pilot Gjuajtës Bombardues" mbas një stazhi njëvjeçar në avionin Mig-17 duke finalizuar mbrojtjen e diplomës në Shkollën e Vlorës. Në libër përshkruhen dhe të veçantat e programit të shkollës, ku në të nuk mungonte përgatitja, formimi si lidership për të shërbyer në strukturat drejtuese në Forcat Ajrore, por dhe zënia e vendit të merituar në strukturat e Ministrisë Mbrojtjes dhe SHP, kohë kur përfaqësimi pothuajse mungonte.

### Rruga drejt ambasadës...

Në faqet e librit zënë vend dhe kujtime nga shoqëria civile dhe ushtarake, histori pilotësh, të bukura dhe të rrezikshme që ishin pjesë e profesionit të pilotit. Fati e deshi që piloti Zaim Kuçi të bënte fluturim me avionin Alpha-jet, Dijon Francë për 35 min. Me interes është dhe një syth ku trajtohet fluturimi dhe diplomacia, lojtarë të së njëjtës fushë. Të jesh diplomat i mirë, do të thotë që ta konsiderosh vërtet detyrë të vështirë, më të vështirë se pilotimi i avionit Mig.

Bazuar në eksperiencën e fituar në

vite dhe formimin e tij jashtë vendit u zgjodh për detyrën Atashe i parë i Mbrojtjes, për të hapur misionin ushtarak pranë Ambasadave të RSH në Francë dhe në Portugali, misioni ushtarak i RSH në Paris që u hap për herë të parë më 5 shtator 2006. Autori thekson se e vlerësova detyrën jo vetëm si diplomaci ushtarak por një mundësi përfitimi ekonomik, një diplomaci të kujdesshme e sjell atë, e vlerësova si dekoratën më me vlerë të karrierës ushtarake, duke përfaqësuar atdheun në tempullin e diplomacisë botërore dhe gjeta kudo tek francezët mirësinë. Franca i'u përgjigj plotësisht nevojave të Shqipërisë me mbështetje të vazhdueshme të atasheut të mbrojtjes francez në Tiranë.

### Njohje me autorin Zaim Kuçi

Libri "Jeta e një piloti ...", të tërheq sepse është shkruar bukur, me ndjenjë dhe sjell shumë kujtime nga koha e vështirë e fluturimeve. Perlat Nazaj, piloti instruktor thekson se Zaimi ishte një student i kujdesshëm, i singert, i apasionuar me avionin, studiues dhe kërkues që binte në sy. Me leximin e librit, unë fluturova përsëri me studentin tim në avionin Tip-61. U ndjeva mirë, i lumtur që ish studentimi im ka arritur një karrierë brilante, i vlerësuar nga autoritetet e lartë evropiane dhe të vendit, njerëz të artit dhe të diplomacisë.

Zaim Kuçi ka përfunduar Shkollën e Lartë e Aviacionit dhe është diplomuar për "Pilot gjuajtës-bombardues", ka studiuar në Akademia e Mbrojtjes, në Kolegji Superior Gjitharmësh të Mbrojtjes dhe në Institutin e Lartë Aeronautik në Paris. Ka kryer kurse mujore dhe javore për Sigurinë dhe Mbrojtjen në SHBA, Hollandë, Hungari, Gjermani dhe Akademia Diplomatike Shqiptare në Tiranë. Karrierën ushtarake e nisi pilot në avionin me helikë Tip 61 (Jak), në avionët reaktiv Mig 15/17 dhe në avionin supersonik Mig-19 deri në shtator 1990. Ka ushtruar detyrat shef i Stërvitjes të Forcave Ajrore, shef i Shtabit të Bazës Ajrore në Kuçovë, zëvendëskomandant i Akademisë të Forcave Ajrore, pedagog në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, shef Sektori i Strategjisë dhe Politikës afatgjatë të FA, këshilltar Ushtarak i Shefit të SHSHP të FA, atashe i Mbrojtjes në Paris/Lizbonë, koordinator/analist, Qendra Kombëtare e Sigurisë dhe Mbrojtjes. Për punë dhe përkushtim ndaj detyrës ushtarake është vlerësuar nga Kuvendi Popullor me medaljen e "Shërbimin Ushtarak", si dhe nga MM për "Për Shërbime në Ministrinë e Mbrojtjes dhe SHSHP të FA" në vitin 2002, "Për Shërbime të Veçanta" SHSHP të FA në vitin 2003 dhe në vitin 2006, si dhe "Medalja e Karrierës" SHSHP të FA në vitin 2011.

## Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare, institucioni i vëzhgimit të hapësirës detare

Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare është një institucion ndërrikasterial që ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare

**M**omenti më i rëndësishëm, që shënon ditën e krijimit e QNOD-së, mbetet data 17.05.2010, kur u zhvillua edhe ceremonia e përvënimit zyrtar të saj. Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD) është një institucion ndërrikasterial që ka për detyrë të sigurojë vëzhgimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planëzimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjislacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar.

QNOD përbëhet nga gjashtë institucione pjesëmarrëse të cilat janë: Ministria e Mbrojtjes (prani 24 orëshe të Rojës Bregdetare); Ministria e Brendshme (prani 24 orëshe të Policisë së Kufirit dhe Migracionit); Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (prani 24 orëshe të Drejtorisë së Shërbimeve Peshkore dhe Akuakulturës); Ministria e Infrastrukturës dhe Energjitikës (prani 24 orëshe të Administratës Detare); Ministria e Financave (prani 24 orëshe të Doganave); Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (kapacitet bashkërenduese sipas nevojës).

QNOD ka për mision garantimin menaxhimin dhe kontrollin e kufijve detarë shqiptarë, sigurinë e jetës në det dhe ndërveprimin e institucioneve shtetërore që kanë përgjegjësi dhe interesa në hapësirën detare.

QNOD është institucion kom-

bëtar që garanton ushtrimin e sovranitetit dhe të drejtave sovraane të shtetit shqiptar në hapësirën detare nëpërmjet menaxhimit të integruar të burimeve kombëtare të institucioneve që kanë përgjegjësi dhe interesa në det.

QNOD bashkërendon dhe drejton: operacionet detare për kontrollin e kufirit detar; operacionet detare kundër trafikut të paligjshëm; operacionet detare të luftës kundër terrorizmit; operacionet detare kundër krimit të organizuar; operacionet e kërkim-shpëtimit dhe dhënies së ndihmës në det; operacionet e antitodtjes; operacionet në mbrojtje të peshkimit; operacionet për ruajtjen e ekuilibrit ekologjik dhe mjedisit detar; operacionet për mbrojtjen dhe mirëadministrimin e pasurisë peshkimore (biomasa ihtiologjike) dhe operacionet për sigurinë e jetës në det.

Praktikat më të përparuara të disa vendeve të zhvilluara në fushën e sigurisë dhe zbatimit të ligjit në det, nuk mund të mos shërbenin si shembuj të mirë, në kushtet e vendit tonë. Bazuar në Kodin Detar dhe ligjin "Për Rojën Bregdetare Shqiptare", fillimisht u krijua si një strukturë operacionale vetëm me personel ushtarak nga Forca Detare. Më pas, një grup pune me pjesëmarrjen e ekspertëve nga gjashtë ministri, përgatitën aktet e duhura nënligjore për organizimin, strukturën dhe funksionimin e kësaj qendre. Me VKM Nr. 954, datë 30.09.2009 (që

më vonë u pasua me akte të tjera nënligjore), u përcaktua organizimi, struktura dhe mënyra e funksionimit të QNOD-së, si dhe bashkëveprimi me institucionet që kanë interesa në det. Ky akt nënligjor, bëri të mundur që në fillim të vitit 2010, të fillojë me operacionalitet të plotë puna e kësaj qendre.

Momenti më i rëndësishëm, që shënon ditën e krijimit e QNOD-së, mbetet data 17.05.2010. Krijimi i kësaj qendre më 17.05.2010, erdhi si një domosdoshmëri për kontrollin e hapësirës detare, në kuadrin e forcimit të Sistemit të Menaxhimit të Integruar të Kufijve, sigurisë së jetës në det dhe bashkëpunimit ndërkufitar, duke patur mbështetjen e Qeverisë Shqiptare dhe të Bashkimit Europian.

Për ritjen e kapaciteteve operacionale të QNOD-së, janë bërë investime ndër vite. SIVHD Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare (financuar nga MM) sistemi i R/komunikimit UHF "TETRA" dhe Sistemi "Blue Box" për monitorimin e anijeve të peshkimit (të financuar nga BE), sistemet "TIMS", "MEMEX", VMRTS/SMART, "MarineTraffic", "ASICUDA" dhe së fundmi "Lloyds Informa", janë disa nga sistemet që përdoren nga personeli i shërbimit në sallën operacionale, të QNOD-së, pa harruar mjetet detare në administrim të RB, PKM dhe Doganës. Në ndihmë të Policisë Kufitare dhe Migracionit (PKM) veprojnë prej vitesh edhe disa anije të "Guardia

di Finanzia"-s. Në QNOD, ushtrojnë veprimtarinë e tyre, përfaqësues nga disa institucione të ndryshme, me detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë në aktet ligjore dhe nënligjore, si më poshtë: Roja Bregdetare (me shërbim 24-orë), Policia Kufitare dhe Migracionit (me shërbim 24-orë), Kapiteneria e Përgjithshme e Porteve (me shërbim 24-orë), Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (me shërbim 24-orë), Drejtoria e Peshkimit (me shërbim 24-orë), Drejtoria Mjedisit dhe Turizmit (me kapacitet bashkërendues). QNOD, shërben si një qendër kombëtare vëzhgimi, monitorimi, drejtimi, bashkëpunimi, koordinimi, evidentimi, raportimi, analizimi, për kontrollin efikas të hapësirës detare, nëpërmjet përdorimit të integruar të aseteve dhe kapaciteteve operacionale, në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar. Përvoja e deritanishme, ka vërtetuar se qasja ndërinstitucionale e materializuar në QNOD, ishte dhe mbetet ajo e duhura dhe më efektive.

Për t'i bërë ballë sfidave të kohës, në fokusin e punës së QNOD-së gjatë këtyre 10 viteve, kanë qenë drejtimi operacional detar sa më efikas, forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional, përdorimi i integruar i aseteve dhe kapaciteteve tekniko-operacionale, implementimit të sistemeve bashkëkohore si dhe studime në kuadër të përmirësimit të sistemeve ekzistuese dhe implementimit të projekteve të reja, zbatimi me korrektesë i akteve ligjore e nënligjore, si dhe përmirësimi i tyre, zhvillimi i trajnimeve dhe stërvitjeve në fusha të ndryshme, etj.

Gjatë procesit të vendimmarrjes është treguar kujdes i vecantë që të pasqyrohen të gjitha nevojat dhe inputet e 3 institucioneve pjesëmarrëse, duke e konsideruar bashkëpunimin si çelësin për përmirësimin e misionit. Aktiviteti operacional i QNOD-së ka shtrirje të gjërë, ku përfshihen shumë fusha përgjegjësie të zbatimit të ligjit në det. Konkretisht, aktiviteti operacional gjatë këtyre 10-viteve përfshin: Operacionet e kërkim-shpëtimit dhe dhënien e ndihmës në det, kontrollin e kufirit dhe luftën kundër trafikut të paligjshëm, kontrollin e legjislacionit për sigurinë hidrolundimore, kontrollin e legjislacionit fiskal dhe doganor, parandalimin dhe mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja, zbatimin e kontrollit të legjislacionit për peshkimin, etj. Në total, QNOD

ka menaxhuar dhe evidentuar 1774 operacione detare, si dhe mbi 700 situata të tjera operacionale. Një rëndësi e veçantë, i është kushtuar punës në grup, për dokumentimin e saktë të të dhënave, analizimin e tyre, si dhe nxjerrjen e mësimave e rekomandimeve të nevojshme për të ardhmen. Funksionimi i grupeve ndërinstitucionale për analizën e ngjarjeve, apo të riskut, zhvillimi i patrullimeve të përbashkëta, etj, kanë kontribuar jo vetëm në forcimin e bashkëpunimit por edhe në rritjen e efikasitetit të punës në tërësi. Ndër prioritetet kryesore të punës

UK Border Force, Zyra e Bashkëpunimit të Policisë Italiane është bërë e mundur kryerja e disa vizitave studimore nga personeli i QNOD-së pranë qendrave homologe, në vende të ndryshme, si: Angli, Francë, Gjermani, Itali, Poloni e Portugali. Këto vizita studimore, kanë krijuar mundësi të reja për personelin e QNOD-së, për tu njohur me eksperiencën më të përparuar në kuadër të zbatimit të ligjit në det, si dhe për shkëmbimin e ideve dhe mendimeve për çështje të ndryshme, në interes të punës. Përmirësimi dhe misionit nëpërmjet vëzhgimit, zbulimit, moni-



së QNOD-së në vazhdimësi ka qenë përgatitja dhe kualifikimi i personelit. Nga zbatimi i planeve vjetore të trajnimit, rezulton se në harkun kohor të 10 viteve janë trajnuar dhe kualifikuar rreth 2700 punonjës të QNOD-së, Rojës Bregdetare, PKM-së, Doganës, Kapitenerive, Peshkimit dhe Mjedisit. Një kontribut të vlerësueshëm në fushën e trajnimeve, në interes të personelit të QNOD-së, kanë dhënë edhe misionet ndërkombëtare që ndihmojnë vendin tonë, si: ICITAP, PAMECA, EXBS, Projekti IPA për Ballkanin Perëndimor, Ambasada Britanike, UNDP, etj. Që nga viti 2010, QNOD është vizituar nga shumë personalitete të vendit, si dhe nga rreth 75 delegacione të huaja, që kanë parë nga afër dhe janë njohur me mënyrën e funksionimit të QNOD-së, si dhe kanë shprehur interes për fuqizimin e kësaj qendre. Me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë si: PAMECA, EXBS,

torimit dhe kontrollit të zbatimit të ligjit në hapësirën tonë detare, si dhe krijimi i një ambienti të sigurtë në këtë hapësirë ka qenë, është dhe mbetet prioriteti kryesor i punës së QNOD-së. Ky vit jubile për QNOD-në, përkon me përfundimin e një dekade me përpjekje, angazhime dhe arritje. Kjo qendër e vogël në numër, falë punës dhe kontributit të të gjithë personelit të strukturave ligjzbatuese në përbërje të saj, ka arritur të koordinoj dhe përdor me efikasitet 4 resurset e vëna në dispozicion, duke krijuar një barrierë ndaj çdo veprimtarie të paligjshme në hapësirën tonë detare. Përvoja e deritanishme, përbën një bazë të qëndrueshme për rritjen dhe forcimin e mëtejshëm të rolit dhe veprimtarisë së QNOD-së. Ajo paraqitet sot si një qendër e konsoliduar, me një eksperiencë 10 vjeçare, e gatshme për tu bërë ballë sfidave të kohës.



Në kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, u mbajtë ceremonia e pranimit të donacionit të pajisje mjekësore nga Republika e Gjermanisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Me këtë rast, ministri i Mbrojtjes Anton Quni, paraprakisht priti në zyrën e tij, ambasadorin e Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë, Joern Rohde. Në fillim ministri Quni e uroi ambasadorin Rohde për detyrën e re dhe mirënjohjen e thellë për mbështetjen e përhershme të Gjermanisë ndaj Kosovës. Ai theksoi, se edhe donacioni që pranojmë sot është në vazhden e ndihmës së madhe të Gjermanisë, ministrisë së saj të mbrojtjes dhe forcave gjermane për ndërtimin, zhvillimin dhe avancimin në stadin aktual të ministrisë dhe forcave tona. Ministri Quni vlerësoi lart edhe angazhimin e oficerëve dhe nënoficerëve gjerman në kuadër të ekipit të NALT nën leadershipin e gjeneralit Best i cili vazhdon traditën e paraardhësve tjerë me profesionalizëm dhe efektivitet të lartë. „Gjermania si vend mik yni, është njëri ndër partnerët tanë kryesor strategjik dhe se sukseset tona të deritashme, bashkë me partnerët tjerë, janë të aritura të përbashkëta“. Nga ana e tij, ambasadori Rohde, ritheksoi zotimin e Gjermanisë për vazhdimin e mbështetjes së FSK-së për të arritur objektivat e saj zhvillimore dhe shprehu konfirmimin për intensifikimin dhe thellimin e mëtejme të bashkëpunimit bilateral. Gjatë takimit ministri Quni shoqërohej nga komandanti i FSK-së, gjeneralletenanti Rahman Rama dhe drejtori i



NË KAZERMËN „ADEM JASHARI“ NË PRISHTINË

## Gjermania jep donacione të rëndësishme për FSK-në

Ky donacion do rrisë gadishmerinë e Shërbimit Mjekësor të FSK-së për të arritur të ashtuquajturin, kapacitet të „Rolit 1“ të NATO-s

Departamentit për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Integritet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha. Pas takimit, ministri Quni dhe ambasadori Rohde, morën pjesë në ceremoninë e pranimit të donacionit të pajisje mjekësore të FSK-së.

Nga ana e tij, gjeneral Rama e falënderoi ambasadorin Rohde dhe stafin ushtarak gjerman për angazhimin e tyre të madh për këtë donacion dhe të gjitha donacionet dhe kontributet e tyre të deritashme për ngritjen dhe zhvillimin e FSK-së.

Ambasadori Rohde gjatë ceremonisë para të pranishmëve tha: „Është kënaqësi e veçantë që sot, gjatë vizitës time të parë në Ministrinë e Mbrojtjes, në emër të Qeverisë Gjermane, kam rastin të dorëzoj një donacion të madh me pajisje mjekësore. Ky donacion do t'i mundësoj Shërbimit Mjekësor të FSK-së për të ngritur gatishmërinë e FSK-së në mënyrë

që ajo të arrijë të ashtuquajturin, kapacitet të „Rolit 1“ të NATO-s. Realizimi i këtij donacioni ka qenë një bashkëpunim gjermano-kosovar në mes të këshilltarëve gjermanë dhe ekspertëve mjekësorë të FSK-së.“.

Në fund, ministri Quni shprehu rëndësinë që kanë këto pajisje për aftësimin e personelit tonë për të qenë të gatshëm gjithmonë për reagim dhe trajtim të ndërsjellë në operacione dhe shpëtimin të jetërave të qytetarëve. „Për çdo jetë të shpëtuar do të jemi krenarë së bashku“ theksoi në fund, ministri Quni. Të pranishëm në ceremoni ishin edhe zyrtarë dhe oficerë nga ambasada dhe forcat gjermane si dhe ata nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës. Donacioni i sotëm është në vazhden e mbështetjes permanente të qeverisë dhe forcave gjermane në kompletimin e aftësive dhe kapaciteteve operacionale të Regjimentit të Mjekësisë së FSK-së dhe shërbimit mjekësor të saj në të gjitha nivelet.

# Emigrantja nga Kosova, sot pilote e Ushtrisë Amerikane

**S**hqiptarja nga Kosova, Valdeta Mehanja, ka një histori jete të jashtëzakonshme. Familja e saj u bë refugjate luftarë gjatë konfliktit në Kosovë dhe përfunduan në kampet e refugjatëve në Gjermani. Pas çlirimit u kthyen në atdhe, por përvoja i kishte lënë një përshtypje të jashtëzakonshme Valdetes e cila vendosi të angazhohej për të kontribuar për njerëz e popuj të tjerë që kalonin vuajtje të ngjashme. Ajo u angazhua si vullnetare e OKB-së në zona konfliktesh me refugjatë.

Në vitin 2004, u punësua si kontraktore nga Shtetet e Bashkuara dhe u vendos në Irak e më vonë në Afganistan. Ishte aty që i lindi dëshira për një karrierë ushtarake dhe për fluturimin. Në 2010, ai nisi ta bënte këtë ëndërr realitet kur erdhi si studente në SHBA për të kryer studimet në Universitetin e Aeronautikës Embry Riddle, Daytona Beach, Florida. Pas diplomimit shërbeu në disa formacione të Ushtrisë Amerikane si dhe iu bashkua në programin (MAVNI) që angazhohet për interesa jetike kombëtare amerikane. Sot, refugjatja nga Kosova është Lejtënante e Dytë e ushtrisë amerikane dhe po përgatitet si pilote e helikopterëve Black Hawk. Në korrik, Këshilli Amerikan i Emigracionit e nderoi me Çmimin e Trashëgimisë Amerikane, që e kanë marrë edhe figura si Gjenerali Colin Powell, Senatori i Amerikës Daniel Inouye, dhe shkrimtarja e aktivistja Gerda Weissman Klein. Valdeta përkrah studimeve dhe shërbimit në ushtri ka gjetur gjithmonë kohë për të ndihmuar kauzën e emigrantëve në SHBA. Njihuni me Valdeten, emigranten shqiptare që u bë oficere e lartë Valdeta Mehanja ia ka përkushtuar jetën përparimit të Shteteve të Bashkuara. Për arsye se nuk u dorëzua kurrë dhe sepse njerëzit që e ndihmuan nuk



hoqën dorë kurrë, Valdeta Mehanja realizoi ëndrrën e saj për t'u bërë nënshtetase amerikane, një oficere e lartë e komisionuar dhe tani po stërvitet që të bëhet pilote e Black Hawk", tha me rastin e dhënies së dekoratës, Beth Werlin, drejtoresha ekzekutive e Këshillit Amerikan të

Emigracionit. Valdeta Mehanja i është mirënjohëse Amerikës që çliroi vendlindjen e saj dhe shpëtoi popullin e saj. Tani, është ajo që punon për ta bërë Amerikën më të fortë. Njihuni me Valdeten, emigranten shqiptare që u bë oficere e lartë.

## KAZERMA "ADEM JASHARI" NË PRISHTINË

### Turqia dorëzon 1 milionë dollarë donacione për FSK-në

**N**ë kazermën „Adem Jashari“ të FSK-së në Prishtinë, u bë pranim-dorëzimi i kontigjentit të dytë të donacionit me veshmbathje ushtarake nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës në vlerë financiare prej rreth një milion dollarë. Ceremonia e pranim-dorëzimit të pajisjeve përkatëse u bë në prani të zyrtarëve dhe oficerëve të logjistikës së Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FSK-së dhe Komandës së Logjistikës si dhe atasheut ushtarak turk në Kosovë me stafin e tij. Në emër të qeverisë turke, donacionin e dorëzoi, atasheu i Republikës së Turqisë, kolonel Ismail Cenkeri Ersoz, kurse ,në emër të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së , e pranoi, oficeri i Departamentit të Logjistikës së SHPFK-së, major Nazmi Zogaj, i cili falenderoi kolonel Ersoz për donacionin e dhuruar dhe mbështetjen e vazhdueshme të ushtrisë dhe shtetit turk për FSK-në.





**M**e ftesë të Ministrisë së Mbrojtjes së Sllovenisë, si nikoqir, zv. Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Kosovës, Faruk Geci dhe drejtori i Departamentit për Bashkëpunimin Ndërkombëtar dhe Integrimet Euroatlantike, kolonel Hasan Hoxha, më 16 shtator 2020, morën pjesë në punimet e Konferencës vjetore të Bashkëpunimit të Mbrojtjes së Evropës Qendrore (The Central European Defence Cooperation-CEDC). Bashkëpunimi Evropian Qendror i Mbrojtjes (CEDC) është iniciativë e bashkëpunimit ushtarak i përbërë nga shtetet e Evropës Qendrore të Austrisë, Republikës Çeke, Sllovakisë, Hungarisë, Sllovenisë dhe Kroacisë dhe Polonisë me status vëzhguesi.

Objektivi i përbashkët i kësaj iniciative është rritja e bashkëpunimit të mbrojtjes, duke përfshirë bashkimin dhe ndarjen e aftësive mbrojtëse të vendeve anëtare si dhe organizimin e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta. Kosova këtë radhë u ftua së bashku me vendet tjera të Ballkanit Perëndimor, pasi që sesioni i sivjetëm i konferencës u fokusua në identifikimin e rrugëve të mundshme për një dialog të zgjeruar të Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së (Common Security and Defence Policy -CSDP -EU) me vendet e Ballkanit Perëndimor. Brenda kësaj teme u vlerësuan edhe nevojat nga pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor dhe u identifikuan format e bashkëpunimit në të ardhmen në formatin CEDC +, me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të partnerëve.

Z. Geci dhe kolonel Hoxha gjatë ekspozesë së tyre, nga perspektiva e Ministrisë së Mbrojtjes prezantuan sistemin e integruar të menaxhimit të krizës në Kosovë, respektivisht procesin e planifikimit, gatishmërisë dhe ekzekutimit e operacioneve dhe masave anti-covid në kuadër të reagimit të përbashkët ndërinstitu-



Kosova në Bashkëpunimin Evropian Qendror të Mbrojtjes (CEDC)

## Stërvitje të përbashkëta me aktorë rajonalë dhe evropianë

Bashkëpunimi Evropian Qendror i Mbrojtjes (CEDC) është iniciativë e bashkëpunimit ushtarak i përbërë nga shtetet e Evropës Qendrore të Austrisë, Çekisë, Sllovakisë, Hungarisë, Sllovenisë, Kroacisë dhe Polonisë me status vëzhguesi

cional, me fokus në aftësitë dhe kapacitetet e angazhuara të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së.

Ata vlerësuan lart mbështetjen nga BE dhe vendet e tjera partnere si dhe shprehën gatishmërinë e plotë për bashkëpunim me vendet e rajonit dhe vendet e tjera në ndarjen e përvojave si dhe gatishmërinë për të kontribuar me pjesëmarrje konkrete në operacionet e përbashkëta kundër pandemisë dhe fatkeqësive tjera.

Ata nënvizuan nevojën për një dialog të zgjeruar të Politikave të Përbashkët e Sigurisë dhe Mbrojtjes së BE-së me Ballkanin Perëndimor, duke vlerësuar misionet e BE-së dhe të NATO-s në rritjen dhe konsolidimin e sigurisë rajonale.

Z. Geci shprehu besimin se Kosova është tashmë në fazën kur mund të ofroj kontributin e saj, veçanërisht në fushën e emergjencave civile dhe gatishmërinë të mbështesë vendet e rajonit në rast krizash. "Tërmeti i vitit të kaluar në Republikën e Shqipërisë dëshmoi nevojën në rritje për bashkëpunim rajonal në reagim të përbashkët dhe Kosova rithekson

gatishmërinë për të bashkëpunuar me strukturat e BE-së ose ato rajonale të mbrojtjes për t'i mbështetur ato në raste të emergjencave humanitare" tha ndër të tjera z. Geci. Lidhur me bashkëpunimin me institucionet e mbrojtjes së BE-së, z. Geci theksoi se Kosova i jep përparësi anëtarësimit në BE dhe natyrisht, Ministria e Mbrojtjes, si të gjitha institucionet e tjera të Republikës së Kosovës, synon të zhvillojë dhe përafrojë bazën ligjore me atë të BE-së, krahas vazhdimin të ndërveprimit brenda Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes. Bashkëpunimin në të ardhmen në formatin CEDC + me qëllim të ndërtimit të kapaciteteve të partnerëve të Ballkanit Perëndimor, përfaqësuesit tanë e vlerësuan shumë të rëndësishëm krahas mbështetjes për ndërtimin e aftësive dhe kapaciteteve të FSK-së në këtë kontekst si dhe zhvillimin e stërvitjeve të përbashkëta me aktorë rajonalë dhe evropianë. Prezantimi i z. Geci dhe kolonel Hoxhës, u përcollën me interesim dhe u vlerësuan lart nga ana e pjesëmarrësve. Për shkak të kufizimeve të krijuara nga masat anti-covid, konferenca u realizua përmes platformës së video-konferencës.

# Gjenerata 24 e Qendrës për Studime Universitare në FSK

**N**ë ambientet e kazer-mës "Adem Jashari", u mbajt ceremonia ushtarake e betimit të kadetëve-studentë të Qendrës për Studime Universitare të FSK-së të gjeneratës së studimeve 2020-2024. Në ceremoninë e organizuar me pjesëmarrje të kufizuara për shkak të masave kundër COVID-19, morën pjesë zv. ministrija e Mbrojtjes, Sadika Kofrc, zv. ministri i Mbrojtjes, Muhametalli Mergjollar, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, zv. komandanti i FSK-së, gjeneralmajor, Enver Cikaqi, drejtori i NALT-it, gjeneral brigade Frank Best, stafi tjetër i lartë ushtarak dhe civil i Ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së, oficerë të NALT-it, këshilltarët ushtarak bilateral, si dhe familjarë të kadetëve – studentë të rinj. Me protokollin e ceremonisë ushtarake, me fjalë përshëndetëse dhe mesazhe urimi, kadetëve-studentë të rreshtuar, stafit drejtues dhe akademik të QSU-së dhe të pranishmëve tjerë, iu drejtua, nikoqiri i ceremonisë, zv. komandanti i QSU-së, kapiten Lirim Bllaca dhe gjeneral Rama, kurse për shkak të angazhimeve tjera jashtë vendit, u lexua letra përshëndetëse me mesazhe urimi e dërguar nga ministri i Mbrojtjes, Anton Quni. Në fjalën e tij, gjeneral Rama, përveç urimeve, theksoi se rrugëtimi i nisur për të realizuar arritjen e standardeve më të larta profesionale dhe akademike do të realizohet me programin tejet sfidues për përgatitje psikike, fizike, profesionale dhe

Fillon viti akademik 2020/21 të QSU-së për gjeneratën-24 të saj me 16 kadetët-studentë të cilët do të ndjekin studimet e rregullta katërvjeçare 2020-2024



intelektuale. "Sot, Ju do të betoheni para flamurit, prindërve, dhe udhëheqësve tuaj, që do të jeni të përkushtuar ndaj vendit, duke pasur gjithmonë parasysh moton e ushtarakut: Detyra, Nderi, Atdheu" tha ai. Gjeneral Rama, vlerësoi lartë të arriturat e QSU-së për 15 vjet me radhë, në funksion të ndërtimit të forcave moderne, profesionale, multietnike, të disiplinuar dhe të trajnuar sipas standardeve të ushtrive perëndimore së bashku me partnerët tanë strategjikë. Ndër të tjera, kadetët e rinj i inkurajoi që ta sfidojnë vetveten sa më shumë dhe ta mbrojnë njëri tjetrin. "Të qëndroni të bashkuar, Një për të gjithë, e Të gjithë për një!" porositi në fund, gjeneral Rama. Me letërrimin, drejtuar kadetëve-studentë të rinj, ministri Quni, çmoi shumë lartë ata, duke i vlerësuar si "E tashmja dhe e ardhmja e forcave tona si dhe Më të mirët prej më të mirëve". Ai kërkoi nga ta, përkushtim të madh gjatë studimeve duke këshilluar që shpirti patriotik të

udhëheq vlerat e moralit, ndërsa profesionalizmi të jetë qëllimi më i lartë gjatë studimeve katërvjeçare. "Si Ministër i Mbrojtjes besoj se me suksesin më të lartë do të realizoni planin mësimor dhe praktik të paraparë dhe me njohuritë e arritura në të ardhmen do të jeni oficerë të NATO-së dhe krah për krah me kolegët e juaj nga ushtri të vendeve anëtare të Aleancës, do të jepni kontributin tuaj në shërbim të paqes, sigurisë dhe stabilitetit kudo që është e nevojshme" theksoi në fund të letërrimit të tij, ministri Quni. Ceremonia përkatëse u organizua me fillimin e vitit akademik 2020/21 të QSU-së për gjeneratën-24 të saj me 16 kadetët-studentë të cilët do të ndjekin studimet e rregullta katërvjeçare sipas planit programor mësimor me module teorike dhe praktike sipas standardeve të akademike më të avancuara ushtarake perëndimore e veçanërisht SHBA-së.

# Britania mbështet transformimin e ushtrisë maqedonase

**G**eneral brigade John Bauron i Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Bashkuar do të zëvendësojë gjeneral-brigade Hugh Lloyd Jones si Këshilltar i Armatës në procesin e saj të transformimit sipas standardeve të Aleancës. Për këtë qëllim, më 10 shtator 2020 në Ministrinë e Mbrojtjes, ministrja Radmilla Shekerinska dhe ambasadorja Britanike Rachel Galloway nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Bashkuar.

„Ky është një shembull i vërtetë se aleanca jep rezultate. Ne jemi mirënjohës Mbretërisë së Bashkuar për mbështetjen e vazhdueshme ndaj Armatës sonë në proceset më të rëndësishme të zhvillimit, siç është transformimi i saj,” tha ministrja Shekerinska.

Ambasadorja Galloway tha se Mbretëria e Bashkuar është e gatshme të vazhdojë dhe thellojë bashkëpunimin tashmë të vendosur në mbrojtje, i cili jep rezultate të shkëlqyera në transformimin e Armatës. Gjenerali Bauron ka përvujtë të gjerë në Forcat e Armatosura Britanike, ka shërbyer në operacione dhe misione në Bosnjë-Hercegovinë



Nënshkruhet Memorandumi i Bashkëpunimit midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Bashkuar në fushën e mbrojtjes.



dhe Irak dhe ka qenë pjesë e Forcave të Sigurisë së Zhvillimit të Pakistanit, në Bregun Perëndimor dhe në Jeruzalem. Pozicioni i tij i fundit

është në Akademinë e Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, ku ai gjithashtu udhëhoqi transformimin e Akademisë.

## SHEKERINSKA TAKON SHEFIN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË HOLLANDËS

**M**inistrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska pati një takim me Shefin e Forcave të Armatosura të Mbretërisë së Hollandës, Admiralin Rob Bauer. Takimi u përqëndrua në promovimin e bashkëpunimit dypalësh të mbrojtjes, sfidat e reja në mbrojtje, pjesëmarrjen në misionet ndërkombëtare dhe mundësitë e ofruara nga poligoni ushtarak Krivolak për mbajtjen e trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.

Ministrja Shekerinska u falënderua për mbështetjen për pranimin në NATO dhe tha se anëtarësimi në Aleancë është një shans për të intensifikuar bashkëpunimin e mbrojtjes midis Maqedonisë së Veriut dhe Mbretërisë së Hollandës. “Dy vendet tona kanë një histori të

## Bashkëpunim midis Armatës maqedonase dhe Mbretërisë së Hollandës

Hollanda do të marrë një rol aktiv përmes strukturave të NATO-s në mënyrë që Armata të përshtatet më shpejtë në Aleancë

shkëlqyeshme të bashkëpunimit në mbrojtje dhe unë jam e bindur se pranimi i Maqedonisë së Veriut në NATO do t’i japë një shtysë të re intensifikimit të këtij bashkëpunimi dhe mbajtjes së trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta”, theksoi ministrja. Admirali Bauer përgëzoi Shekerinskën për anëtarësimin në NATO dhe mandatin e ri të Qeverisë dhe shprehu gatishmërinë që Hol-

landa të marrë një rol më aktiv në udhëheqjen e Maqedonisë së Veriut përmes strukturave të NATO-s në mënyrë që vendi ynë të përshtatet më shpejtë në Aleancë. Komandanti i Forcave të Armatosura të Hollandës ishte për vizitë tre-ditore në Maqedoninë e Veriut, e cila, sipas Ambasadës së Hollandës, shënon anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë Veriore në NATO.





## KAZERMA “BORO MENKOV” NË KUMANOVË

# Shekerinska në Kumanovë, aty ku për 6 vite do jetë selia e SEEBRIG

Rreth 30 përfaqësues të ushtrive tona fqinje do të punojnë dhe do të jetojnë me familjet e tyre në gjashtë vitet e ardhshme dhe kjo është një investim i mirë në rolin tonë të ri si një anëtar i NATO-s”

“**K**umanova bëhet selia e njëjës prej nismave më të rëndësishme rajonale, Brigadës së Evropës Juglindore dhe në gjashtë vitet e ardhshme, ky do të jetë vendi ku do të jetë e vendosur kjo Brigadë si pjesa kryesore e iniciativës që filloi 22 vjet më parë në Shkup dhe në të cilën si shtet mësuam mësimet e para për zhvillimin e aftësive të përbashkëta mbrojtëse”, deklaroi ministrja e Mbrojtjes Radmila Shekerinska, e cila vizitoi objektin ku deri në vitin 2026 do të jetë e vendosur Komanda e Brigadës së Evropës Juglindore (SEEBRIG), e themeluar me marrëveshjen e nënshkruar në Shkup në vitin 1998.

Ministrja Shekerinska tha se 2020 është vit i suksesshëm në mbrojtje dhe dha dy arsye për festim-anëtarësimin në NATO dhe zhvendosjen e Komandës SEEBRIG në Kumanovë. Ajo shtoi se në gjashtë vitet e ardhshme kemi mundësinë të

tregojmë se mund të jemi nikoqirë funksional, të shkëlqyeshëm dhe shumë bashkëpunues.

“Megjithatë na u desht me shumë kohe të behemi anëtar të Aleancës në krahasim me vendet tjera pjesëmarrëse në SEEBRIG, ne nuk ndaluan të bashkëpunojmë, gjë që ishte një mundësi të përgatitemi më shpejtë për anëtarësimin në NATO. Tani, kur të gjithë anëtarët e kësaj nisme janë edhe anëtarë të NATO-s, do të mund të dëshmojmë edhe në nivel të rajonit tonë, por edhe në kuadër të NATO-s, se jemi aleatë, mirëpo parasegjithash jemi fqinjë të zgjuar dhe të mirë”, tha ministrja. Shekerinska në emër të Qeverisë shprehu kënaqësi për shpejtësinë me të cilën u përgatitem për këtë projekt të rëndësishëm dhe për kushtet që u krijuan për pjesëtarët e Komandës së Brigadës të cilët vijnë nga gjashtë shtete dhe gjashtë armata.

„Nuk është hera e parë që jemi qendra e një iniciative rajonale, por për herë të parë ne jemi qendra dhe nikoqiri i një iniciative kaq të madhe rajonale në të cilën rreth 30 përfaqësues të ushtrive tona fqinje do të punojnë dhe do të jetojnë me familjet e tyre në gjashtë vitet e ardhshme dhe kjo është “Një investim i mirë në rolin tonë të ri si një anëtar i NATO-s.”

Brigada e Evropës Juglindore është formuar në vitin 1999, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit Rajonal në fushën e mbrojtjes e njohur si Marrëveshje për Forca Shumëkombëshe Paqeruajtëse për Evropën Juglindore (IEDM), e nënshkruar në vitin 1998 në Shkup. Anëtarët e SEEBRIG janë Maqedonia e Veriut, Shqipëria, Bullgaria, Greqia, Rumania dhe Turqia. Pritëse të Komandës së Brigadës deri më tani kanë qenë Plovdivi, Konstanca, Stambolli dhe Larisa.

# Ministrja Radmilla Shekerinska-Matej Tonin

## Bashkëpunimi në mbrojtje fiton një intensitet të ri si aletë të NATO-s

**M**inistrja e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska në Ministrinë e Mbrojtjes u takua me homologun e saj sloven, Matej Tonin, i cili në kuadër të vizitës shtetërore të Presidentit të Republikës së Sllovenisë, Borut Pahor, qëndroi për një vizitë zyrtare në Maqedoninë e Veriut. Ministrja Shekerinska falënderoi për mbështetjen e Republikës së Sllovenisë në rrugën drejt NATO-s dhe shprehu besimin se bashkëpunimi në mbrojtje midis dy vendeve do të marrë një intensitet të ri brenda Aleancës.

„Mbështetja e fortë e Sllovenisë për NATO-n dhe BE-në ka qenë një motiv i fortë për ne për të rritur përpjekjet tona për të arritur qëllimet tona strategjike. “Në mua, si ministre e Mbrojtjes, ju gjithmonë do të keni një bashkëbisedues dhe një partner për bashkëpunim në fushën e trajnimeve, stërvitjeve dhe misioneve të përbashkëta,” tha ministrja Shekerinska.

